


■ Udhëzues për  
standardet e hartimit



të planeve menaxhuese të

# trashëgimisë kulturore

Korrik 2020



# **Udhëzues për standardet e hartimit të planeve menaxhuese të trashëgimisë kulturore**

Korrik, 2020

# Tabela e përmbajtjes

<b>LISTA E SHKURTESAVE</b>	4	4.1. Identifikimi i objektit	43
<b>PARATHËNIE</b>	5	4.2. Historia	44
<b>1. HYRJE</b>	7	4.3. Përshkrimi	45
1.1. Çka është trashëgimia kulturore?	9	<b>5. FAZA E DYTË E PLANIFIKIMIT TË MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE – FAZA E ANALIZËS / VLERËSIMIT</b>	51
1.2. Pse udhëzues për trashëgiminë kulturore?	10	5.1. Vlerësim i rëndësisë – Vlerat, autenticiteti dhe/apo integriteti	53
<b>2. ÇKA ËSHTË MENAXHIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE?</b>	15	5.1.1 Përcaktimi i vlerës	53
2.1. Parakushtet për plan të suksesshëm dhe të zbatueshëm për menaxhimin e trashëgimisë kulturore (PMTK)	20	5.1.2. Autenticiteti dhe/ose Integriteti	56
2.2. Tipologjia e planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore	22	5.2. Gjendja e Konservimit	57
2.3. Si strukturohet një plan i menaxhimit?	24	5.2.1. Fushat e veprimit	58
<b>3. FAZA ZERO, FAZA FILLESTARE E PLANIT PËR MENAXHIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE</b>	27	5.2.2. Analiza SWOT	59
3.1. Titulli	28	5.2.3. Vlerësimi i rrezikut	60
3.2. Deklarata e rëndësisë	28	<b>6. FAZA E TRETË – PLANI I VEPRIMIT</b>	63
3.3. Vizioni	29	6.1. Objektivat specifike	64
3.4. Parimet e planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore në Kosovë	30	6.2. Aktivitetet	65
3.5. Synimet	32	<b>7. STRUKTURAT MENAXHUESE, MONITORIMI DHE KONTROLLI</b>	67
3.6. Brendimi	32	<b>8. PËRFUNDIME</b>	71
3.7. Palët e interesit	36	<b>BIBLIOGRAFIA</b>	73
<b>4. FAZA E PARË E PLANIFIKIMIT TË MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE – FAZA E IDENTIFIKIMIT</b>	41	<b>INSTRUMENTET LIGJORE DHE NORMAT E PADETYRUESHME</b>	75
		<b>LISTA E ILUSTRIMEVE</b>	76

## Lista e shkurtesave

<b>OBK</b>	Organizatë me Bazë në Komunitet
<b>MTK</b>	Menaxhimi i trashëgimisë kulturore
<b>KMTK</b>	Këshilli për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore
<b>PMTK</b>	Plani Menaxhues i Trashëgimisë kulturore
<b>CLEAR</b>	Bashkëpunues - i kufizuar - emocional - i vlerësueshëm - i rafinueshëm
<b>GA</b>	Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
<b>ICCROM</b>	Qendra Ndërkombëtare për Studime të Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurive Kulturore
<b>MBE</b>	Menaxhim i bazuar në përjashtim
<b>MBF</b>	Menaxhim i bazuar në fakte
<b>MBO</b>	Menaxhim i bazuar në objektiva
<b>MBR</b>	Menaxhim i bazuar në reagim
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>Res</b>	Rezolutë
<b>SDG 2030</b>	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 të Kombeve të Bashkuara
<b>Metoda SMART</b>	Specifike - e matshme - e arritshme - realiste - me kuadër kohor.
<b>SOC</b>	Gjendja e konzervimit
<b>SOM</b>	Gjendje e menaxhimit
<b>SOS</b>	Deklaratë për Rëndësinë
<b>SVM</b>	Zonat e Veçanta të Mbrojtjes
<b>SWOT</b>	Fuqitë - Dobësitë - Mundësitë - Kërcënimet
<b>UN</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>UNESCO</b>	Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara
<b>UNMIK</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administratë të Përkohshme në Kosovë
<b>VBM</b>	Menaxhim me bazë në vlera

## Parathënie

Qasja e OSBE-së përballë garantimit të trashëgimisë kulturore është e gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Përpyekjet e Misionit për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë janë komponentët thelbësorë në objektivin tonë më të gjerë për të nxitur dialogun dhe për të ndërtuar besimin mes komuniteteve të ndryshme të Kosovës. Përgjatë 20 viteve të fundit, Misioni i OSBE-së në Kosovë jo vetëm që ka monitoruar zbatimin efektiv të "Zonave të veçanta të mbrojtura", por edhe ka siguruar ndërtim të kapaciteteve dhe ndërgjegjësim në dobi të publikut dhe institucioneve në Kosovë. Me kalimin e viteve jemi bindur se kontribuimi në ndërtimin e kapaciteteve është një nga mënyrat më efikase dhe të suksesshme për të kontribuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve të kryera nga OSBE-ja kanë çuar në intensifikimin e dialogut me partnerët tanë, duke mundësuar kështu zbatimin e programeve të përshtatura për t'iu përgjigjur nevojave specifike.

Aktivitetet tona në krijimin e kapaciteteve i shohim si mundësi për të lidhur praktikën e ruajtjes, bazuar në standarde ndërkombëtare, me zhvillimin e mundësive të biznesit për të valorizuar trashëgiminë kulturore duke respektuar plotësisht ndjeshmëritë lokale. Rrjedhimisht, ofrojmë seanca trajnimi jo vetëm për përfaqësuesit e institucioneve publike dhe organizatave joqeveritare, por edhe për praktikuesit dhe studentët të cilët fitojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime të reja.

Ky *"Udhëzues për standardet e hartimit të planeve të menaxhimit të trashëgimisë kulturore"* përbën moment historik të angazhimit të OSBE-së në forcimin e kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e trashëgimisë dhe mjedisin që e rrethon atë. Bazuar në përvojën e ekspertëve ndërkombëtarë dhe falë njohurive të partnerëve tanë lokalë, ky manual do të sigurojë mjetet thelbësore për të përgatitur plane të menaxhimit të trashëgimisë kulturore që janë plotësisht të zbatueshme për situatën në Kosovë. Për më tepër, falë kësaj qasjeje të "trainimit të trajnuesve" përmbajtja do të shpërndahet tek ekspertët dhe institucionet tjera relevante që janë të përkushtuara për të ruajtur kulturën dhe natyrën.

Në mesin e shumë ekspertëve, të cilët kontribuuan në këtë udhëzues, dëshiroj t'ia shpreh falënderimet e veçanta profesoreshës Amra Hadžimuhamedović, për kontributet e saj shumë thelbësore. Përvoja dhe ekspertiza e saj ndihmuan në sqarimin e ndërlikimeve praktike të menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

Shpresojmë që ky udhëzues të jetë i dobishëm për praktikuesit, si në institucione, në akademi ashtu edhe në komunitetin e OJQ-ve. Besojmë që ruajtja e trashëgimisë kulturore bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare mund të shërbejë për të ndërtuar një kuptim të përbashkët të trashëgimisë sonë të përbashkët.

Prishtinë, korrik 2020



**Ambasadori Jan Braathu**

Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë



An aerial photograph of an archaeological site. The site features a large rectangular enclosure with thick stone walls. Inside the enclosure, there is a central square structure with a flat roof. To the left of this central structure is a smaller, irregularly shaped structure with a scalloped or floral border. The ground is a mix of dirt and sparse grass. The lighting suggests it is either early morning or late afternoon, casting long shadows.

## 1. Hyrje

Ky Udhëzues i standardeve për hartimin e planeve të menaxhimit të trashëgimisë kulturore ("Udhëzuesi") është rezultat i përpjekjeve afatgjata të Misionit në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për të kontribuar në mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë.



## Menaxhimi solid është faktor kyç për mbrojtjen, promovimin dhe bartjen e suksesshme të trashëgimisë kulturore tek gjeneratat e ardhshme.

Në vitin 2015, OSBE-ja inicioi një proces nga poshtë-lart për hartimin e udhëzimeve që do të duheshin përdorur si pikënisje për planet e ardhshme të menaxhimit. Rrjedhimisht, OSBE-ja kontrakttoi Prof. Amra Haxhimuhamedoviq për të ofruar këshilla dhe udhëzime mbi hartimin e Udhëzuesit. Në këtë punë gjithashtu kontribuuan një game e pjesëmarrësve, që përfaqësojnë fushën e gjerë të trashëgimisë kulturore (p.sh. pjesëtarët e objekteve të trashëgimisë, si dhe përfaqësuesit e institucioneve kulturore dhe autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore). Rrjedhimisht, iniciativa siguroi jo vetëm që të merren në konsideratë standardet ndërkombëtare dhe "praktikat më të mira" të pranuar globalisht, por edhe pasqyrim të përvojave, pritjeve dhe nevojave të pjesëmarrësve nga ky Udhëzues.

Planet e menaxhimit paraqesin një sërë parimesh për menaxhimin e mirëfilltë të objekteve të trashëgimisë që përshkruajnë themelet ligjore, procedurat administrative

dhe strukturat përfshirë burimet në dispozicion (buxheti, stafi dhe infrastruktura). Megjithatë, efikasiteti i një plani të menaxhimit është i lidhur fort me planin e veprimit, i cili përshkruan hapat e nevojshëm për zbatimin e plotë të planit.

Udhëzuesi nuk e zëvendëson planin e menaxhimit, pasi çdo objekt i trashëgimisë është individual dhe kërkon grup përkatës të veprimeve. Sidoqoftë, ky publikim duhet të kontribuojë në të kuptuarit se si funksionon një plan menaxhimi dhe cilat parime duhet të merren parasysh gjatë procedurës së hartimit. Për më tepër, Udhëzuesi ofron pasqyrim të instrumenteve për hartimin e një plani të tillë. Megjithatë, një plan efikas i menaxhimit nuk është "i skalitur në gur", por kërkon rishikime të rregullta, p.sh. në intervale pesë-vjeçare.

Ky Udhëzues u adresohet të gjitha palëve të interesit të përfshira në menaxhimin e një objekti të trashëgimisë. Edhe nëse objekti i trashëgimisë ka plan të menaxhimit, Udhëzuesi do të shërbejë si resurs në interpretimin e planeve. Udhëzuesi është hartuar për publikun dhe synon të kontribuojë në mbrojtje të qëndrueshme, me bazë në të drejtat e njeriut të trashëgimisë kulturore në Kosovë.

## 1.1 Çka është trashëgimia kulturore?

Nuk ka ndonjë përkufizim të veçantë të trashëgimisë kulturore sot. Sidoqoftë, ekziston një dakordim global që vlerat e trashëgimisë vazhdimisht evoluojnë, veçanërisht bazuar në njohjen e rëndësisë së trashëgimisë kulturore për shoqëritë. Kjo domethënie rrjedh nga vlerat e brendshme dhe ato instrumentale të trashëgimisë. Vlerat e trashëgimisë përbëhen nga attribute të prekshme dhe të paprekshme, natyrore dhe të krijuara nga njeriu, të luajshme dhe të paluajshme. David Lowenthal ka trajtuar këtë marrëdhënie komplekse të procesit të vazhdueshëm dhe thelbësisht të rëndësishëm për çdo komunitet dhe person në përkufizimin e tij të trashëgimisë kulturore, i cili thekson rëndësinë e trashëgimisë në botën aktuale të globalizmit, konflikteve, presioneve të zhvillimit dhe migrimit.<sup>1</sup>

Koncepti i hapur i trashëgimisë është mirë i përmbledhur në nenin 2 të *Konventës Faro 2005*:

*"(...) trashëgimia kulturore është grup i burimeve të trashëguara nga e kaluara, të cilat njerëzit i identifikojnë, pavarësisht nga pronësia, si pasqyrim dhe shprehje e vlerave, besimeve, njohurive dhe traditave vazhdimisht në evoluim. Ajo përfshin të gjitha aspektet e mjedisit që vijnë nga ndërveprimi midis njerëzve dhe vendeve në raport me kohën".<sup>2</sup>*

Pajtohemi me Barbara Kirshenblatt-Gimblett që trashëgimia kulturore përfaqëson një burim nga e kaluara, që është "i vjetër", por që merr një "jetë të dytë" (që do të thotë se do të ketë funksion të ri si "trashëgimi") dhe i atribuohet vlerë e posaçme nga shoqëria ("e çmuar", "e rrallë", "në zhdukje").<sup>3</sup>

1 Shih Lowenthal, D., *The Past is a Foreign Country (E kaluara është një vend i huaj)* (Kembrixh: Cambridge University Press, 1985).

2 Shih Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës mbi vlerën e trashëgimisë kulturore për shoqërinë (Këshilli i Evropës, Faro, 27 tetor 2005).

3 Shih Kirshenblatt-Gimblett, B., "Theorizing Heritage" (Teorizim për trashëgiminë), *Etnomuzikologji* 39 (Champaign / Illinois: University of Illinois Press, 1995), ff. 367–380.

## 1.2 Pse udhëzues për trashëgiminë kulturore?

Ekzistojnë një varg udhëzuesish për planifikimin e menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Ai i botuar nga *Qendra Ndërkombëtare për Studime për Ruajtjen dhe Restaurimin e Pasurive Kulturore* (ICCROM), si dhe të shkruara nga dy teoricienë të njohur të trashëgimisë kulturore, Jukka Jokilehto dhe Bernard Feilden më 1998<sup>4</sup> (të përkthyer në shumë gjuhë, duke përfshirë shqipen) ishte thjesht një embrion për shumë bursa, studime rastesh dhe udhëzues praktikë.

Atëherë pse ta kemi një tjetër udhëzues? Trashëgimia kulturore është kuptuar tashmë si koncept gjithnjë në zhvillim. Nevoja për menaxhim duhet të marrë përgjigje në kontekste të ndryshme historike, ekonomike, kulturore dhe tradicionale. Kosova përfaqëson një nga kontekstet më sfiduese në të cilat duhet të vendosen korniza specifike dhe metoda menaxhimi për të qenë i zbatueshëm. Neni 9 i Kushtetutës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë.

Megjithëse, sipas Ligjit për trashëgiminë kulturore<sup>5</sup>, menaxhimi i trashëgimisë kulturore nuk është i detyrueshëm, ai përmendet në nenin 6.6: "Politikat për ruajtjen, menaxhimin dhe shtimin e fushave të konservuara arkitekturale përcaktohen së bashku nga Institucioni kompetent dhe autoritetet qendrore dhe lokale për planifikim hapësinor."

Larmia gjuhësore, fetare dhe formale e trashëgimisë në Kosovë duhet të trajtohet në përputhje me standardet universale që "çdo person ka të drejtë të angazhohet për trashëgiminë kulturore sipas zgjedhjes së tij/saj, duke respektuar të drejtat dhe liritë e të tjerëve, si aspekt i të drejtës për të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore, të paraparë me nenin 27 të *Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara* (1948)<sup>6</sup> si dhe e garantuar me nenin 15, nënparagrafin 1a) të

---

4 Shih Feilden, BM, Jokilehto, J., *Management Guidelines for World Cultural Heritage Sites* (Udhëzime Menaxhimi për Objektet e Trashëgimisë Kulturore Botërore). Botimi i Dytë (Romë: ICCROM, 1998).

5 Ligji nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore, 1 korrik 2008.

6 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, (Paris: Asambleja e Përgjithshme e KB, Res. 217A, 10 dhjetor 1948), [https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/eng.pdf](https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf) [qasur më 4 mars 2020].

*Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966)*<sup>7</sup> siç theksohet në preambulën e Konventës Faro të Këshillit të Evropës.<sup>8</sup>

Veçantia e sistemit të mbrojtjes së trashëgimisë në Kosovë është paraparë me Ligjin për zona të veçanta të mbrojtura,<sup>9</sup> i cili "siguron mbrojtjen e manastireve ortodokse serbe, kishave, objekteve të tjera fetare, si dhe objekteve historike dhe kulturore me rëndësi të veçantë për komunitetin serb të Kosovës, si dhe komunitetet tjera në Kosovë, përmes krijimit të zonave të veçanta të mbrojtura (ZVM)".<sup>10</sup> Ligji i lartpërmendur parasheh regjim mbrojtës shumë kufizues, duke paraparë aktivitetet e ndaluara<sup>11</sup> dhe të kufizuara<sup>12</sup>. Pasi që zonat e veçanta të mbrojtura përbëjnë pjesë të ansambleve historike urbane ose peizazheve kulturore, sistemi i menaxhimit duhet të parashihet posaçërisht për të mundësuar zbatimin e plotë të Ligjit. Ky gjithashtu kërkon angazhimin e plotë të palëve të interesuara në të gjitha fazat e menaxhimit, në mënyrë të ndjeshme, bazuar në standardet dhe të drejtat e njeriut për respektimin dhe promovimin e diversitetit fetar dhe kulturor.

Përveç kësaj, institucionet e Kosovës, përballen me nevojën për përparim e zhvillim të shpejtë, por dhe nevojën për praktika të mira, si dhe krijim të kapaciteteve të mira. Këto do të siguronin qëndrueshmëri ndaj proceseve të zhvillimit që janë të nevojshme në fushën e trashëgimisë më shumë se në çdo fushë tjetër, për të parandaluar keqpërdorimin e trashëgimisë për qëllime të prodhimit të konflikteve dhe për të mundësuar valorizimin e tij në të mirë të të gjithëve.

Parimet themelore të menaxhimit tashmë janë shpjeguar në detaje në udhëzuesit tjerë, të cilët mund të zbatohen globalisht.<sup>13</sup> Mirëpo këtu, burimet e referimit, ato teorike, doktrinale ose rastet e studimit do të citohen kurdo që zgjidhjet e ofruara nga to mund të jenë të pranueshme.

---

7 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, (Nju Jork: AP-OKB, 16 Dhjetor 1966, Res AP 2200A [XXI]), <https://www.un.org/ruleoflaw/blog/document/international-covenant-on-economic-social-and-cultural-rights/> [qasur më 4 Mars 2020].

8 Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për vlerën e trashëgimisë kulturore për shoqërinë (Këshilli i Evropës, Faro, 27 tetor 2005), <https://www.coe.int/en/web/culture-and-heritage/faro-convention> [qasur më 4 nëntor 2019].

9 Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtjes, 4 qershor 2008;

10 *Neni 1, po aty*;

11 *Neni 5, po aty*;

12 *Neni 6, po aty*;

13 Shih Udhëzuesit p.sh nga Jokilehto dhe Feilden, Ringbeck, Howard, ICCROM dhe English Heritage; referencat e plota janë tek Bibliografia.

Ky Udhëzues fokusohet në raste për të prezantuar parimet, metodat dhe udhërrëfyesin që mund të zbatohet në Kosovë dhe që mund të sigurojë zgjidhje me përfitime të shpejta që kërkohen nga palët e interesit.

Ky Udhëzues është krijuar si rezultat i trajnimeve për profesionistët e trashëgimisë, aktivistët dhe shërbyesit civilë në Kosovë. Rasti i Novobërdës është zgjedhur si rast didaktik për trajnim, të organizuar nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Novobërda ka brenda vetes një zonë të caktuar si ZVM. Ky rast, për shkak të natyrës ilustruese të tij dhe kompleksitetit që përmbledh shumicën e rasteve në Kosovë, edhe pse është trajtuar si simulim virtual, shërben për të paraqitur arritshmërinë praktike të këtij udhëzuesi dhe paraqet pjesë përbërëse të tij.

Përmes rastit të mësipërm didaktik: simulimit të një plani të menaxhimit, Udhëzuesi ka përfituar në kuptimin se ai ka qenë praktik dhe i dobishëm.

Gjatë seancave trajnuese me një gamë të gjerë pjesëmarrësish, si përfaqësues të agjencive të trashëgimisë kulturore, profesionistë, akademikë dhe studentë, u bë e qartë se mbrojtja e trashëgimisë kulturore kërkon qasje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse, që nuk duhet të kufizohet p.sh. vetëm tek çështjet e teknikave të restaurimit. Shtrirja e trashëgimisë kulturore në një peizazh të mrekullueshëm kulturor, si ai që gjendet përreth kështjellës mesjetare të Novobërdës, ka nxitur pjesëmarrësit të shqyrtojnë temën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në kuadër më të gjerë, duke marrë parasysh edhe çështjet e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky Udhëzues pritet të ndihmojë publikun dhe palët e interesit, të cilat vlerësojnë aspekte të ndryshme të trashëgimisë në Kosovë, që të punojnë së bashku në kuadër të veprimit publik, me qëllim që të mbështesin dhe bartin të gjitha llojet e trashëgimisë tek brezat e ardhshëm dhe të përfitojnë nga ajo, si në kuptimin social ashtu edhe ekonomik sot.

Ky Udhëzues synon të krijojë simulimin e planit të menaxhimit për Novobërdën dhe është rezultat i një procesi kompleks dy vjeçar (2017 - 2018) të:

- identifikimit të palëve të interesit dhe përafrimit të tyre,
- ofrimit të trajnimeve për menaxhimin e trashëgimisë kulturore, historinë e saj, standardet ndërkombëtare dhe menaxhimin,
- lehtësimin e ndëveprimit intelektual dhe ekspertizës midis palëve të interesuara,
- sigurimit të informatave për rrjetin ligjor dhe institucional, ndërsa diskutohet mbi mundësitë tij, pikat e forta dhe të metat, si dhe strategjitë e ardhshme,
- forcimit të njohurive në lidhje me standardet bashkëkohore ndërkombëtare dhe praktikrat e mira,
- sigurimit të mundësive për pjesëmarrësit në procedurën e hartimit të Udhëzuesit për të zgjeruar rrjetin e tyre profesional nga njëra anë dhe për të krijuar ndjenjën e pronësisë intelektuale mbi udhëzimet e hartuara bashkërisht nga ana tjetër,
- promovimit të përgjegjësisë dhe entuziazmit në lidhje me mbrojtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë, duke iniciuar procese të reja në objekte të ndryshme të frymëzuara nga projekti i ndërtimit të kapaciteteve udhëhequr nga OSBE-ja (p.sh. Kalaja e Prizrenit, bërthama historike urbanistike e Prizrenit), dhe
- zhvillimit të planit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore si politikë e përbashkuar, e formuluar nga palët e interesit të përfaqësuara, si reagim ndaj situatave të njohura dhe të parashikueshme në të cilat trashëgimia kulturore ose ka ose mund të ketë rol vendimtar.

Gjatë procesit të hartimit të Udhëzuesit mund të vërehet një zhvendosje në perspektivë, nga një objekt arkeologjik tek peizazh të gjallë kulturor të objektit të lartpërmendur.



Synimet e gjithë procesit të hartimit ishin si më poshtë:

1. Ndërtimi i kapaciteteve të personelit që punon në fushën e trashëgimisë kulturore në Kosovë, në lidhje me menaxhimin e trashëgimisë kulturore (MTK);
2. Krijimi i një rrjeti të qëndrueshëm mes ekspertëve të angazhuar në mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovë;
3. Kontekstualizimi i standardeve ndërkombëtare; zhvillimi i një modeli të hapur me mundësi të përshtatjes të planit MTK (PMTK) i zbatueshëm për kontekstin e trashëgimisë në Kosovë.





## 2. Çka është menaxhimi i trashëgimisë kulturore?

Menaxhimi i objekteve të trashëgimisë kulturore duhet të sigurojë mbrojtjen e tyre afatgjatë në përputhje me nevojat e publikut, duke marrë parasysh qëndrueshmërinë e tyre. Sidoqoftë, synimi për menaxhim gjithëpërfshirës të trashëgimisë kulturore nuk është vetëm mbrojtja e objekteve të trashëgimisë për të tashmen, por edhe bartja e trashëgimisë kulturore për gjeneratat e ardhshme.



Një sistem efikas menaxhimi varet nga lloji i trashëgimisë në mjedisin e tij më të gjerë shoqëror, kulturor dhe legjislativ duke marrë parasysh veçoritë e tij. Rrjedhimisht, menaxhimi nuk paraqet vetëm një tërësi të caktuar instrumentesh, por pasqyron edhe perspektivat kulturore dhe burimet në dispozicion.


Në fund fare, menaxhimi i trashëgimisë kulturore nuk duhet të tkurret në një instrument vetëm për ruajtjen e një situatë të caktuar, por duhet të ofrojë edhe instrumente për zhvillimin e objektit të trashëgimisë, në mënyrë që të sigurojë bazë të qëndrueshme për jetesën.

Për të përmbushur këto kritere, çdo plan menaxhimi duhet të jetë rezultat i aktiviteteve të ndërlidhura të politikave komunitare, organizimit, planifikimit, kontrollit dhe orientimit të resurseve për të arritur synimet e politikave.

Menaxhimi i trashëgimisë kulturore është kuptuar si kornizë për ruajtje të integruar të trashëgimisë kulturore në fund të shekullit të 20-të, ndonëse përpjekjet për menaxhimin e trashëgimisë kulturore kanë ndodhur si një lloj reagimi ndaj shkatërrimit të shkaktuar nga Lufta e Dytë Botërore. Menaxhimi i trashëgimisë kulturore është i rrënjësor në marrëveshjet ndërkombëtare të Këshillit të Evropës, përkatësisht *Konventën Evropiane të Kulturës* (1954), parimet e *Deklaratës së Amsterdimit* (1975), *Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitektonike të Evropës* (1985), *Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike* (1992, e rishikuar), *Konventën Evropiane të Peizazhit* (2000), *Konventën Kornizë të Faros për Rëndësinë e Trashëgimisë për Shoqërinë* (2005), si dhe në *Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore* (1972), si dhe më gjerë, në pranimin modern të qasjes së mbrojtjes së trashëgimisë kulturore që është e bazuar në të drejtat e njeriut.



Menaxhimi i trashëgimisë kulturore në mënyrë më të thjeshtuar pasqyron rrotën e famshme që rrotullohet përherë, e cila simbolizon zhvillimin e qëndrueshëm të bazuar në konzervimin e integruar të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Pikënisja është të kuptohet trashëgimia, pasi të jetë kuptuar ajo mund të vlerësohet; kur vlerësohet trashëgimia, atëherë ka nevojë të mbrohet; pasi të jetë mbrojtur, mund të gëzohet. Rrota rrotullohet në kuptimin që sa më shumë ta gëzoni, aq më shumë e kuptoni; sa më shumë ta kuptoni, aq më shumë e vlerësoni; sa më shumë ta vlerësoni, aq më shumë e mbron; sa më shumë ta mbron, aq më shumë e gëzoni, e kështu me radhë.



Ilustrimi 1: "Rrota që sillet" e menaxhimit të trashëgimisë kulturore

Versioni i rishikuar i "Udhëzuesit Operativ për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore", i cili ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2005, e bën planin e menaxhimit (ose sistemin e dokumentuar të menaxhimit) të detyrueshëm për pasuritë e regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore.<sup>14</sup>

<sup>14</sup> Shih Paragrafin 108, Udhëzuesi operativ për zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore (Udhëzuesi Operativ 2019), (Paris: UNESCO-Komiteti i Trashëgimisë Botërore dhe Qendra e Trashëgimisë Botërore, 2019), <https://whc.unesco.org/document/178168> [qasur më 12 shkurt 2020].

Kjo solli edhe nevojën për përcaktimin, përshkrimin dhe shpjegimin e procesit të planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

Shumica e udhëzuesve janë botuar pas vitit 2005. Disa prej atyre që përdoren më shpesh, përveç udhëzuesit të parë nga Jokilehto & Feilden<sup>15</sup>, janë ata që janë shkruar nga Birgitta Ringbeck<sup>16</sup>, Peter Howard<sup>17</sup>, një grup autorësh në ICCROM<sup>18</sup>, English Heritage<sup>19</sup>, si dhe nga shumë organe të tjera të trashëgimisë. Ky Udhëzues i referohet përvojës së ilustruar në dëshmitë e tyre, por duhet po ashtu të ofrojë metodë inovative për aplikimin e ideve me pronësi lokale.

Vizionet dhe ndryshimet e këtyre që nga viti 2005 janë të lidhura thellësisht me nocionin e Trashëgimisë Botërore, veçanërisht me konceptin e vlerës së jashtëzakonshme universale (OUV) të objektit të Trashëgimisë Botërore, gjë që përcaktohet nga tri shtylla ose nga tre qarqe<sup>20</sup>, që përbëhen nga:

1. Vlera në përputhje me kriteret (paragrafi 77, Udhëzuesi Operativ 2019),
2. Autenticiteti dhe/ose integriteti, dhe
3. Dispozitat ligjore dhe menaxhimi.



---

15 Feilden, BM, Jokilehto, J., *Management Guidelines for World Cultural Heritage Sites (Udhëzime Menaxhimi për Objektet e Trashëgimisë Kulturore Botërore)*. Botimi i Dytë (Romë: ICCROM, 1998).


16 Ringbeck, B., *Management Plans for World Heritage Sites (Planet e menaxhimit për Objektet e Trashëgimisë Botërore)*. Udhëzues praktik (Bon: Komisioni gjerman për UNESCO, 2008), [https://www.unesco.de/sites/default/files/2018-05/Management\\_Plan\\_for\\_World\\_Heritage\\_Sites.pdf](https://www.unesco.de/sites/default/files/2018-05/Management_Plan_for_World_Heritage_Sites.pdf) [qasur më 2 nëntor 2019].

17 Howard, P., *Heritage (Trashëgimia): Management, Interpretation, Identity (Menaxhimi, interpretimi, identiteti)* (Leicester: University Press, 2003).

18 UNESCO, *Managing Cultural World Heritage (Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore)* (Paris: UNESCO- Qendra e Trashëgimisë Botërore, 2013) <https://whc.unesco.org/document/125839> [qasur më 2 nëntor 2019].

19 English Heritage, *Building Environment (Practical Building Conservation) (Mjedisi Ndërtimor (Konzervimi praktik i objekteve)* (Farnham: Ashgate Publishing, 2014).

20 Dhjetë kriteret e paragrafit 77, Udhëzuesi Operativ 2019, ofrojnë një sërë kushtesh për përfshirjen e një pasurie kulturore ose natyrore në Listën e Trashëgimisë Botërore. Për regjistrim si Trashëgimi Botërore, institucioni nominues duhet të zgjedhë dhe arsyetojë të paktën një kriter. Kriteret (i) - (vi) kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore, ndërsa kriteret (vii) - (x) vlejné për trashëgiminë natyrore.



## Ilustrimi 2: Përkufizimi i "vlerës së jashtëzakonshme universale" të trashëgimisë botërore

Udhëzuesi Operativ 2019 për Konventën e Trashëgimisë Botërore parasheh si vijon:

Paragrafi 108: "Secila pasuri e nominuar duhet të ketë plan të mirëfilltë menaxhimi ose sistem tjetër të dokumentuar të menaxhimit, i cili duhet të specifikojë se si duhet të ruhet vlera e jashtëzakonshme universale e pasurisë, mundësisht përmes mënyrave pjesëmarrëse<sup>21</sup>".

Paragrafi 110: "sistemi efektiv i menaxhimit varet nga lloji, karakteristikat dhe nevojat e pasurisë së nominuar dhe konteksti i saj kulturor dhe natyror<sup>22</sup>".

Për qëllim të këtij Udhëzuesi, është e mundur të përmblihet përvoja në lidhje me planifikimin e menaxhimit dhe të konkludohet shkurt se: një plan menaxhimi është koncept i planifikimit dhe veprimit të integruar, i cili përcakton qëllimet dhe masat për mbrojtjen, konservimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e një objekti të trashëgimisë kulturore ose natyrore, si dhe ofron vizionin, qëllimet dhe veprimet që janë paraparë për të adresuar nevojat e banorëve dhe shfrytëzuesve të objektit të trashëgimisë kulturore dhe/ose natyrore, si dhe mbështetjen nga ta.


Plani i menaxhimit duhet të hartohet dhe të zbatohet përmes një qasje të bashkërenduar dhe të baraspeshuar, që është e qëndrueshme me kalimin e kohës dhe që forcon identitetin lokal. Ai gjithashtu duhet të sigurojë një sistem të ofrimit të përfitimeve të prekshme për komunitetin lokal.

<sup>21</sup> Udhëzues Operativ për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore (Udhëzuesi Operativ 2019), (Paris: UNESCO-Komiteti i Trashëgimisë Botërore dhe Qendra e Trashëgimisë Botërore, 2019), <https://whc.unesco.org/document/178168> [qasur më 12 shkurt 2020].

<sup>22</sup> Po aty.

Plani i menaxhimit duhet të baraspeshojë dhe të bashkërendojë aspekte dhe procese të ndryshme të tilla si: legjislati, identifikimi, vlerësimi, mbrojtja ligjore, konservimi (mbrojtja, restaurimi, rindërtimi, përshtatja), rehabilitimi dhe ringjallja, shfrytëzimi, mirëmbajtja, ruajtja, interpretimi, prezantimi, monitorimi, kontrollimi dhe hulumtimi.

## 2.1 Parakushtet për plan të suksesshëm dhe të zbatueshëm për menaxhimin e trashëgimisë kulturore (PMTK)



Ilustrimi 3: Kushtet për një plan për menaxhimin e trashëgimisë kulturore

Planifikimi për menaxhimin e trashëgimisë kulturore duhet të jetë prioritet i identifikuar nga aktorët politikë në të gjitha nivelet, dhe procesi duhet të mbështetet në përkrahjen politike që nga fillimi i tij dhe gjatë gjithë fazave të planifikimit dhe zbatimit. Sidoqoftë, mbështetja politike nuk është e mjaftueshme nëse nuk është pjesë e një trekëndëshi të qëndrueshëm që mund të përmbillet vetëm nëse plotësohen dy parakushtet shtesë.

Këto parakushte që janë të rëndësishme së barabartë përfshijnë pëlqimin dhe mbështetjen e plotë e të gjitha palëve të interesit (pëlqimi nga palët e interesit mund të arrihet përmes fazës fillestare që kërkon kohë dhe qasje strukturore ndaj bashkëpunimit strategjik të hisedarëve) dhe burime, njerëzore dhe financiare. Megjithatë ndarja e buxhetit bëhet mbi baza vjetore për secilën fushë të veprimit, është e rëndësishme që të sigurohen burimet financiare të nevojshme për planifikimin dhe veçanërisht për zbatimin. Burimet njerëzore janë parakusht tjetër që duhet të plotësohet në të gjitha fazat e planit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Kjo përfshin punësimin dhe kapacitetet e plota, si dhe përgjegjësitë e personelit të punësuar.

I tërë procesi i planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore duhet të zbatohet si proces i negociatave të vazhdueshme në lidhje me idetë dhe masat që paraqiten mes palëve të interesit, që është i strukturuar nga standardet ligjore dhe profesionale. Ekzistojnë tetë hapa të përgjithshëm për të cilat palët e interesit janë përgjegjës për të arritur planifikim të suksesshëm të menaxhimit. Ata duhet:

1. Të bien dakord për fushëveprimin dhe qëllimin e PMTK;
2. Të japin kontributin dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e mbledhjes së informatave;
3. Të japin kontributin dhe të bien dakord për përshkrimin e pasurisë dhe vlerësimin e rëndësishme të saj;
4. Të bien dakord për kushtet themelore;
5. Të përcaktojnë synimet dhe objektivat për të zbatuar marrëveshjet;
6. Të japin kontributin dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive për identifikimin e fushave të veprimit dhe zhvillimin e programit të punës dhe planit të veprimit;
7. Të monitorojnë përparimin e shënuar në bazë të programit dhe planit të veprimit;
8. Të rishikojnë PMTK çdo pesë vjet dhe kohë pas kohe nëse është e nevojshme.

## 2.2 Tipologjia e planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore

Ekzistojnë lloje të ndryshme të planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Zgjedhja e llojit (modelit) zakonisht bazohet në traditën, sistemin shoqëror dhe politik, burimet në dispozicion dhe situatën e përgjithshme në lidhje me objektin e trashëgimisë kulturore.

Modelet mund të përzihen dhe të kombinohen për të siguruar plan sa më real dhe sa më të zbatueshëm. Modelet themelore janë:

1. **Menaxhimi në bazë të objektivit (MBO)** është model i krijuar për të përmirësuar gjendjen fillestare në bazë të objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë. Objektivat zakonisht përkufizohen si të përgjithshme dhe të veçanta për fusha të ndryshme të veprimit. Objektivat duhet të përkufizohen me kujdes e me pëlqimin e plotë të të gjitha palëve të interesit.
2. **Menaxhimi në bazë të fakteve (MBF)** është model ku të dhënat grumbullohen, analizohen dhe maten për të përmirësuar gjendjen e përgjithshme.
3. **Menaxhimi në bazë të përjashtimit (MBE)** është metodë, e cila në menaxhimin e trashëgimisë kulturore nënkupton ose a) përjashtimin e atyre veprimtarive që devijojnë nga puna e rregullt në objekt apo që janë të dëmshme për objektin e trashëgimisë, ose b) organizimin e tërë procesit të bazuar mbi vlerën e jashtëzakonshme të një komponenti, situatë të jashtëzakonshme ose ngjarje të jashtëzakonshme.
4. Modeli i **Menaxhimit në bazë të reagimit (MBR)** parashikon monitorim të vazhdueshëm të kushteve dhe proceseve në objektin e trashëgimisë dhe planifikimin e veprimtarive si reagim ndaj situatës ose incidenteve.
5. **Menaxhimi i bazuar në vlera (VBM)** është filozofia e menaxhimit dhe qasja që krijon veprime të cilat do të rritin vlerat e objektit të trashëgimisë kulturore (ato artistike, historike, dokumentare, simbolike, peizazhin e qytetit, arsimore, ekonomike, etj.). Ky model e konsideron procesin e vlerësimit të vlerës si më kryesorin në fazën e dytë të planifikimit të menaxhimit.
6. **Menaxhimi i bazuar në komunitet (CBM)** nganjëherë quhet qasja nga poshtë-lart dhe përfaqëson modelin e decentralizuar të menaxhimit me qasjen më të gjerë pjesëmarrëse. Pjesëtarët e komunitetit identifikojnë, përballen dhe marrin pjesë në gjetjen e zgjidhjeve për çështjet që kanë të bëjnë me objektin e trashëgimisë kulturore. Në

kontekstin e Trashëgimisë Botërore, qasja e bazuar në komunitet ka prioritet, siç theksohet për shembull, në Objektivat Strategjike (“5 C”) të Trashëgimisë Botërore: “Të rritet roli i komuniteteve për zbatimin e Konventës për Trashëgimi Botërore”.<sup>23</sup>

Kur bëhet vlerësimi i kontekstit kulturor dhe politik i një objekti të trashëgimisë, kombinimi i disa modeleve të menaxhimit mund të duket si zgjidhja më e mirë, sikur kombinimi i tre modeleve kryesorë: **Menaxhimi në bazë të objektivit, menaxhimi në bazë të vlerës dhe menaxhimi në bazë të komunitetit**. Kjo "metodë hibride" përfshin palët e interesit si pronarë të planit të menaxhimit dhe përfshin shumë aspekte të parimeve aktuale të trashëgimisë.

Ky model novator ofron mundësi për të krijuar një lloj të avancuar të menaxhimit të objektit të trashëgimisë, duke siguruar nivelin më të lartë të mundshëm të pronësisë nga palët e interesit.

Ky model bazohet në qasjen mbarë-tematike dhe mbarë-sektoriale për shkak të kompleksitetit të objekteve të trashëgimisë, veçanërisht kur ato formojnë tërësi urbane ose peizazhe kulturore në të cilat njerëzit jetojnë, punojnë, pushojnë dhe investojnë. Koncepti i planit është që të bashkërendojë qasjet sektoriale me qëllim të përfitimit nga mundësitë dhe burimet lokale.



---

<sup>23</sup> Paragrafi 56 (5), Udhëzimet operative për zbatimin e Konventës për Trashëgimi Botërore (udhëzimet operative 2019), (Paris: Qendra e UNESCO për Trashëgimi Botërore dhe Komiteti për Trashëgimi Botërore, 2019), <https://whc.unesco.org/document/178168> [qasur më 12 shkurt 2020].





### 2.3 Si strukturohet një plan i menaxhimit?

Ekzistojnë pesë module thelbësore të nevojshme të një plani të menaxhimit:<sup>24</sup>

1. Masat legjislative, rregullatore dhe kontraktuale për mbrojtje;
2. Kufijtë për mbrojtje efektive;
3. Zonat tampon;
4. Sistemet e menaxhimit;
5. Shfrytëzimi i qëndrueshëm.

Ato gjithashtu theksojnë se plani i menaxhimit varet nga konteksti dhe natyra e objektit të trashëgimisë. Përveç moduleve thelbësore, plani i menaxhimit mund të përfshijë:

- praktika tradicionale, jo vetëm si trashëgimi e paluajtshme, por edhe si metodë e përjetësimit dhe interpretimit të trashëgimisë;
- dokumente urbanistike ose të planifikimit hapësinor dhe rregulla në përputhje me legjislacionin pozitiv (ato ekzistuese ose të ardhshme që mund të kërkohen);
- informacione të hollësishme për gjendjen fillestare, veçanërisht për gjendjen e ruajtjes;
- kërcënimet e mundshme dhe menaxhimi gjegjës i rrezikut të tyre;
- ndërgjegjësimin dhe promovimin;
- numrin e vizitorëve dhe “kapaciteti mbajtës” i objektit të trashëgimisë;
- udhëzimet për vizitorë dhe përkthimi;
- mundësitë e trajnimit;
- lëvizjen;
- komponentin e turizmit;
- monitorimin, institucionet që marrin pjesë në menaxhim; dhe
- numrin dhe kualifikimin e personave të cilët do të përfshihen drejtpërdrejt në zbatimin e planit të menaxhimit.


---

24 Kapitulli II. F, po aty.

Procesi i planifikimit të menaxhimit që sugjerohet për kontekstin e Kosovës është i përbërë nga katër faza të njëpasnjëshme si në vijim:

0. Faza fillestare, përgatitore, zakonisht quhet faza e nisjes;
  1. Faza e identifikimit;
  2. Faza e analizimit;
  3. Faza e planifikimit që përfshin instrumentet e monitorimit, strukturat e zbatimit dhe dispozitat e kontrollit.

Secila fazë do të shpjegohet në më shumë hollësi në kapitullin vijues.



Struktura e planit për menaxhim do të pasqyrojë fazat e tërë procesit. Figura në vijim paraqet ndërvarësinë e segmenteve të ndryshëm të planit për menaxhim në drejtimet vertikale, horizontale dhe diagonale të organizimit.



Ilustrimi 5:  
Ndërvarësia e segmenteve të ndryshme të procesit për planifikimin e menaxhimit

### 3. Faza zero, faza fillestare e planit për menaxhimin e trashëgimisë kulturore

Faza paraprake ose fillestare përbëhet nga përcaktimi i objektit të trashëgimisë, pëlqimi për vizionin dhe qëllimet e përgjithshme. Kjo fazë zakonisht quhet faza zero për shkak se gjetjet, konstatimet dhe marrëveshjet e arritura gjatë kësaj faze përcaktojnë nëse plani është i nevojshëm, nëse vendimi për fillimin e procesit të planifikimit është i realizueshëm, d.m.th., nëse ka mbështetje politike dhe nga komuniteti, dhe nëse ekzistojnë burime njerëzore dhe financiare që mund të sigurojnë qëndrueshmërinë e tij. Forma dhe përmbajtja e planit burojnë nga çështjet kryesore që identifikohen në fazën fillestare. Faza fillestare nuk duhet lënë anash, dhe të gjitha komponentët e saj duhet të zhvillohen me vëmendje, të diskutohen dhe dakordohen.

### 3.1 Titulli

Titulli i dokumentit të planit për menaxhim duhet të jetë i qartë përkitazi me emrin e objektit të trashëgimisë dhe kategorinë e tij, si dhe duhet të pasqyrojë vizionin. Titulli duhet të jetë lehtësisht i njohshëm, i veçantë dhe që mbahet mend. Titulli është treguesi i parë i strategjisë së brendimit.

### 3.2 Deklarata e rëndësisë

*Deklarata e Rëndësisë* paraqitet gjithmonë e para, ndonëse nuk shkruhet e para. Ajo duhet të jetë përmbledhje e shkurtër dhe gjithëpërfshirëse e çdo informacioni të rëndësishëm në lidhje me objektin e trashëgimisë. Duhet të tregojë qartë pse objekti i trashëgimisë meriton mbrojtje dhe pse nevojitet një plan menaxhimi. Ajo duhet të përbëhet nga:

- Informacioni themelor identifikues siç janë emri i objektit të trashëgimisë, vendndodhja dhe funksioni i tij ose një karakteristikë tjetër e rëndësishme.
- Përmbledhja e shkurtër e historisë së objektit – kur është ndërtuar, nga kush; ndryshimet në formën e tij dhe përdorimi, gjendja aktuale dhe shfrytëzimi.
- Përmbledhja e shkurtër e përshkrimit – lloji i objektit të trashëgimisë, madhësia, komponentët, vetitë e vlerave, renditja, materiali, hollësitë, shtesat domethënëse, humbjet, etj. Harta që tregon vendndodhjen e objektit në mjedisin e tij më të gjerë do të ishte e dobishme.
- Thelbi i deklaratës së rëndësisë ka të bëjë me vlerat – pse objekti ka vlerë, cili është niveli i autenticitetit dhe integritetit të tij.
- Testi i autenticitet, që bëhet në përputhje me *Dokumentin Nara për Autenticitet*<sup>25</sup> (forma dhe dizajni, materiali dhe thelbi, përdorimi dhe funksioni, vendndodhja dhe mjedisi, fryma dhe ndjenjat dhe faktorët e tjerë të brendshëm dhe të jashtëm) duhet të zbatohet vetëm për vetitë kulturore të vlerave të objektit të trashëgimisë.

---

25 Dokumenti Nara mbi Autenticitetin (Paris: ICOMOS, 1994), <https://www.icomos.org/charters/nara-e.pdf> [qasur më4 nëntor 2019]

- Kushtet e integritetit vlerësohen për vetitë natyrore dhe kulturore. Kushtet e integritetit shërbejnë për të matur se deri në çfarë mase objekti, apo komponentët e tij, është i plotë ose i paprekur siç përcaktohet me anë të paragrafit 88 të *Udhëzimeve operative 2005*<sup>26</sup> për Konventën për Trashëgiminë Botërore: "Ekzaminimi i kushteve të integritetit, kërkon vlerësimin se deri në çfarë mase prona: përfshin të gjitha elementët e nevojshëm për të shprehur vlerën e saj të jashtëzakonshme universale; është e madhësisë së përshtatshme për të siguruar përfaqësimin e plotë të karakteristikave dhe proceseve që përçojnë rëndësinë e pronës; vuan nga efektet e pafavorshme të zhvillimit dhe/ose moskujdesit."
- Kushtet aktuale të objektit të trashëgimisë dhe kërcënimet kryesore.
- Konstatimin se çka duhet të bëhet lidhur me konservimin, shfrytëzimin, interpretimin, turizmin dhe hulumtimin.

Është e rëndësishme që deklarata e rëndësisë të shkruhet në mënyrë pozitive, bashkë me faktet më të rëndësishme dhe konstatimet e vlerësimit të nxjerra në mënyrë kuptimplote, duke trajtuar çështjet thelbësore me konstatimin që nënkupton nevojën për menaxhim.

### 3.3 Vizioni

Vizioni është shprehje narrative e asaj që duam të arrijmë nëse një plan afatgjatë zbatohet në mënyrë ideale. Deklarata e vizionit mund të shprehet me një ose më shumë shprehje të përgjithshme, ose si deklaratë e përgjithshme me qëllime jo të matshme. Vizioni përfshin edhe bindjet dhe parimet kryesore të planifikimit të menaxhimit. Vizioni duhet të jetë i rrënjosur në ëndrrat, shpresat dhe nevojat e komunitetit vendas dhe palëve të drejtpërdrejta të interesit, duhet të jetë frymëzues dhe motivues, mjaft i gjerë për të përfshirë objektiva të veçanta dhe për ta përshtatur planin e veprimit. Është e këshillueshme që të dilet me disa parulla për vizionin, si për shembull:

- Novobërda e shëndetshme, e pasur, e gjelbër dhe e qëndrueshme.
- Novobërda, qyteti i shkëlqyeshëm i arit dhe argjendit.

---

<sup>26</sup> Udhëzimet operative për zbatimin e Konventës për Trashëgiminë Botërore (Udhëzimet operative 2005), (Paris: Qendra e UNESCO për Trashëgimi Botërore dhe Komiteti për Trashëgimi Botërore, 2005), <https://whc.unesco.org/archive/opguide05-en.pdf> [qasur 24 tetor 2019].

- Trashëgimia e larmishme e Novobërdës, pasuri dhe përgjegjësi.

### 3.4 Parimet e planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore në Kosovë

Duke qenë se trashëgimia kulturore në Kosovë është njohur në nivel ndërkombëtar si faktor i rëndësishëm politik, parimet universale të metodave të konservimit të integruar duhet të promovohen nga procesi i planifikimit të menaxhimit. Ato bazohen kryesisht në *Kartën Evropiane për Trashëgiminë Arkitekturore (1975)*, *Deklaratën e Amsterdimit (1975)*, *Konventën kuadër të Këshillit të Evropës për vlerën e trashëgimisë kulturore për shoqërinë - Faro (2005)* dhe *Raportin Global për Kulturën të UNESCO: E ardhmja urbane (2016)*.

#### PARIMI 1.

Trashëgimia kulturore nuk përbëhet vetëm nga monumentet më të rëndësishme: ajo gjithashtu përfshin trashëgiminë gjuhësore, grupe dhe komplekse të ndërtesave jo-monumentale, nga periudha të ndryshme, mjedisi i saj natyror apo i krijuar nga njeriu, rregullimet e tokës dhe peizazhi që ka karakter ose të dizajnuar, ose shoqëruar, si dhe komponentët natyrorë dhe të paluajjtshëm.

#### PARIMI 2.

Mbrojtja dhe shfrytëzimi i trashëgimisë kulturore duhet të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, demokracinë, sundimin e ligjit dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë.

#### PARIMI 3.

Trashëgimia kulturore dhe natyrore është pasuri publike e pazëvendësueshme e vlerave kulturore, sociale dhe ekonomike e që është një lloj burimi i zhvillimit.

#### PARIMI 4.

Trashëgimia kulturore dhe natyrore duhet të trajtohet në atë mënyrë që njerëzit dhe vlerat njerëzore të vendosen në qendër të saj, ndërsa siguron zhvillim të baraspeshuar social dhe ekonomik në mënyrë të qëndrueshme.

#### PARIMI 5.

Trashëgimia kulturore luan rol të rëndësishëm në arsim.

#### PARIMI 6.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore ndihmon në promovimin e dialogut midis kulturave dhe feve në Kosovë.

#### PARIMI 7.

Trashëgimia kulturore duhet të jetë temë e pasqyrit të vazhdueshëm, hulumtimit shkencor dhe botimeve.

#### PARIMI 8.

Planifikimi i integruar i menaxhimit të trashëgimisë kulturore duhet të bazohet në qasjen ndër-tematike dhe ndër-sektoriale nga vizioni në veprim, me përfshirjen dhe bashkëpunimin e të gjithëve.

#### PARIMI 9.

Menaxhimi i trashëgimisë kulturore duhet të bëhet përmes sinergjisë së shkathtësive mes të gjitha palëve përgjegjëse të interesit për masat ligjore, administrative, financiare dhe teknike.

#### PARIMI 10.

Planifikimi i integruar i trashëgimisë kulturore në Kosovë duhet të kontribuojë në zhvillimin e bazuar në "qasjen 3P" (siç përcaktohet nga *Raporti Global për Kulturën nga UNESCO: E Ardhmja Urbane*<sup>27</sup>)

“Me fokus në njerëz (**people centered**), e bazuar në vend (**place based**) dhe **politika të integruara (integrated policies)**”.

---

27 UNESCO, *Kulturë: e ardhmja urbane; raport global mbi kulturën për zhvillimin e qëndrueshëm urban* (Paris: UNESCO, 2016), <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000245999> [qasur më 15 nëntor 2019].



### 3.5 Synimet

Duke pasur parasysh që modeli i planifikimit të menaxhimit është "planifikimi në bazë të objektivave", procesi duhet të fillojë me identifikimin e qëllimeve të përgjithshme në mënyrë të qartë. Për më tepër, pasi që planifikimi sipas objektivave është i kombinuar me "menaxhimin e bazuar në vlera" (VBM) dhe "menaxhimin e bazuar në komunitet" (CBM), synimet duhet të jenë në përputhje me vlerat dhe për ato duhet rënë dakord në procesin e udhëhequr nga komuniteti. Ato zakonisht formulohen në atë mënyrë për të zgjedhur përmirësimin dhe promovimin e vlerave. Synimet duhet të jenë në përputhje me vizionin dhe deklaratën e rëndësisë. Procesin e përcaktimit të synimeve është i rëndësishëm për tërë planifikimin e menaxhimit dhe për efikasitetin e menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

### 3.6 Brendimi

Duke qenë se trashëgimia kulturore njihet si burim i zhvillimit, idetë e politikave korporative, veçanërisht brendimi i vendit përmes trashëgimisë, janë paraqitur në menaxhimin e trashëgimisë gjerësisht që nga viti 2000. Sipas teorive, format e brendimit kanë ekzistuar që në fazat e para parahistorike të njerëzimit; brendimi – si proces i njohur dhe i etiketuar – është përmendur gjatë shekullit të 20-të, por paraqitja e tij në disiplina të ndryshme të menaxhimit mund të gjurmohet që nga ardhja e mijëvjeçarit.

Përkufizimet e brendimit janë të shumëfishta, dhe asnjëra prej tyre nuk mund të konsiderohet si finale dhe konvencionale. Erminio Putginano pohon që:

*“Brendimi është ndërmarrje për krijimin e botës. Ka të bëjë me formimin e një botëkuptimi të bazuar në vlera, besime dhe premtime dhe jetësimin e saj përmes simboleve, tregimeve dhe përvojave. Është veprim narracioni e bisede dhe nënkupton kontribut shumë aktiv nga të gjitha palët e përfshira - të gjithë janë të përfshirë në gjenerimin dhe interpretimin e tij (organizata, agjenci, klientë dhe komuniteti në*

*përgjithësi). Nëse botëkuptimi është bindës dhe i rëndësishëm atëherë ai është në gjendje që të ndryshojë mendime dhe sjellje.”<sup>28</sup>*

Brendimi i vendit bazuar në perceptimin e vlerave të një vendi – shprehur në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimisë – është vërtetuar si strategjia më e suksesshme për ndërtimin, komunikimin dhe paraqitjen e perceptimit të identitetit të një vendi. Reputacioni i vendit që ndërtohet përmes procesit kompleks të brendimit është mjet gjithëpërfshirës për të tërhequr dhe inkurajuar aktivizimin dhe angazhimin, para së gjithash, të popullsisë vendase dhe talentin, krenarinë dhe ndjenjën e identitetit me qëllim që të nxisë zhvillim harmonik përmes biznesit specifik dhe investimeve. Brendimi është gjithashtu mjet i "marketingut të destinacionit" për publikun e gjerë për të tërhequr vizitorë, investitorë dhe blerës.

Natyrisht, brendimi mund të jetë edhe pozitiv, edhe negativ, varësisht nga strategjia e "krijimit të vendit" ose, zakonisht, bazuar në mungesën e strategjisë së brendimit ku përvoja e përdoruesve bëhet burimi i vetëm krijues i brendimit. Brendimi dhe besueshmëria e tij vendosin për reputacionin e një vendi të caktuar: A duhet të bazohet në bukuritë natyrore, diversitetin kulturor, veprimtarinë e caktuar njerëzore ose burimet natyrore? Jo vetëm çështjet e mirëqenies, të tilla si pasuria e trashëgimisë arkitektonike dhe arkeologjike, mjedisi i pastër, kuzhina e mirë, mikpritja, por edhe aspektet "negative", si konflikti, bllokimi i trafikut, rrugët e ndyta, objektet e trashëgimisë që janë lënë pas dore, mbishkrimet, krimi dhe pasiguria në kontribuojnë në mospranimin e një objekti të trashëgimisë.

*“Trashëgimia ka potencial për të qenë elementi kyç për brendimin e vendit duke siguruar autenticitet, dallueshmëri dhe besueshmëri për brendimin e vendit.”<sup>29</sup>*

Trashëgimia e një vendi të caktuar mund të perceptohet ndryshe përmes strategjive të ndryshme të brendimit. Ajo mund të bazohet në një vlerë të caktuar të përzgjedhur dhe vetitë e tyre apo në qasjen tërësore dhe gjithëpërfshirëse ndaj vlerave

---

<sup>28</sup> Beverland, M., *Brand Management: Co-creating Meaningful Brands* (Newbury Park: SAGE, 2018).

<sup>29</sup> Historic England, *Heritage Counts 2017: Heritage and the Economy* (London: Historic England, 2017), <https://content.historicengland.org.uk/content/heritage-counts/pub/2017/heritage-and-the-economy-2017.pdf> [accessed 20 November 2018].

dhe vetive të tyre. Brendimi duhet të theksojë identitetin e veçantë dhe dallues të një vendi – shumë vende sot mund të përshkruhen si vende të trashëgimisë së pasur, peizazhe të bukura dhe ushqimit të mirë. Me qëllim që të ketë prosperitet, secili vend i trashëgimisë duhet të identifikojë veçoritë e veta më të dallueshme dhe t'i publikojë ato përmes mediave të ndryshme të komunikimit të brendimit.

Mediumet interpretuese të dobishme për komunikimin e brendeve janë, *ndër të tjera*, vendi, imazhi, fletushka interpretuese me hartë, një sërë fletëpalosjesh me histori të shkurtra, libri me udhëzime për të gjithë zonën, një sërë panelesh grafike në vendet e zgjedhura, tregimi i historive, zhvillimi i postimeve të historive të shkurta, ekskurzionet me ciceron, ngjarjet e trashëgimisë, filmat, muzika, shfaqjet televizive, ngjarjet, faqet e internetit dhe mediumet tjera elektronike, si dhe forma të tjera të kulturës popullore dhe të një sërë ngjarjesh e aktiviteteve që do të ndihmojnë për të gjallëruar zonën.


Zhvillimi i pjesës së dukshme të një brendi bazohet në hartimin e logos, emrit, ngjyrave, formave, simboleve dhe sloganeve. Pjesët e saj të padukshme janë vlerat, zakonet, traditat, marrëdhëniet shoqërore, besimet, etj. Për më tepër, ngjarja specifike historike, vendi i trashëgimisë, procesi i trashëgimisë, shprehja e trashëgimisë së paprekshme, speciet specifike të florës ose faunës, ose përbërës të tjerë dhe kombinimi i tyre i veçantë mund të shërbejë për qëllime të brendimit. Shembuj, ndër të tjerë janë, autobusët e kuq dhe kabinat e kuqe të telefonit si brend i Londrës, *pizzanapolitana* si brend i Napolit, Kulla Eiffel dhe moda si brend i Parisit, qëndisja dhe zbukurimi me ar si brend i Toledos, minierat e qymyrit dhe Vrima e Madhe si brend i Blaenavonit, arkeologjia klasike romake dhe objektet katolike si brend i Romës, gildët e rilindasve dhe ata tregtar si brend i Firencës, shkatërrimi i murit ndarës dhe ribashkimi si brend i Berlinit, rrëfimi i historisë së Romeo dhe Xhulietës si brend i Veronës, etj.

Nared dhe Razpotnik-Visković rendisin përbërësit e mëposhtëm të brendimit efektiv të vendit<sup>30</sup>:

1. Njerëzit lokalë që ruajnë traditat, zakonet, besimet dhe marrëdhëniet me objektet e trashëgimisë fizike;
2. Ikonat, ose atributet më domethënëse dhe më tërheqëse të vlerave në një vend të caktuar;

---

30 Nared, J., Razpotnik-Visković, N. (eds.), *Menaxhimi i Vendeve të Trashëgimisë Kulturore në Evropën Juglindore* (Ljubljana: Založba ZRC, 2014).

- 
3. Sipërmarrësit, p.sh. ofruesit e turizmit;
  4. Shërbime të turizmit autentik individual vendas;
  5. Zbulimet (destinacione dhe histori të reja)

Brendimi duhet të jetë autentik, i besueshëm, që tregon kulturën e vendit, duhet të bazohet në avantazhin konkurrues që vendi ka krahasuar me vendet e tjera, dhe duhet të kontribuojë në rritjen e atraktivitetit nga pikëpamja e vizitorëve, investitorëve, turizmit, partneriteteve globale për hulumtime lokale dhe edukimit me bazë në trashëgimi.

Lloje të ndryshme të industrisë, prodhimit, dizajnit dhe tregtisë mund të jenë të rrënjësura në brendin e vendit, duke ndjekur parimin e famshëm të brendimit të verës "rajoni i origjinës".

Brendimi duhet të bazohet në prezantimin dhe interpretimin gjithëpërfshirës të trashëgimisë dhe jo në periudhat dhe ndërtesat e veçanta. Për të nxitur brendimin e vendit të trashëgimisë është e rëndësishme të planifikoni festivale të trashëgimisë, si pjesë e ngjarjeve të rregullta kalendarike, të ofroni shërbime dhe programe krijuese të dizajnuara në mënyrë të posaçme, të ringjallni pasuritë, përbërësit ose shprehjet e trashëgimisë së harruar ose të lënë pas dore.

Duke pasur parasysh që trashëgimia kulturore ka funksion domethënës në formimin e arsimit, identitetit, kulturës, mjedisit shoqëror, ekonomisë, roli i saj në procesin e brendimit të vendit ofron shumë mundësi. Mund të simbolizojë një vend të caktuar, aftësitë tradicionale mund të përdoren për të prodhuar një produkt specifik dhe të veçantë, një biznesi i ri mund të shfrytëzojë brendet e trashëgimisë për të promovuar dhe tregtuar produktin e tij, pasuritë kulturore dhe natyrore janë skenografi të rëndësishme në film, reklama, spote muzikore, industri televizive, etj.<sup>31</sup>

---


31 Qendra Kërkimore Shkencore e Akademisë Sllovene të Shkencave dhe Arteve (Slloveni), *Modeli i Planifikimit Mjedisor të Trashëgimisë Kulturore për EJT D6.2: Modeli i Planifikimit të Mjedisit për Vendet e Trashëgimisë Kulturore në Evropën Juglindore* (2014), [http://www.Environmental+planning+model+for+cultural+heritage+sites+in+Southeast+Europe%20\(1\).pdf](http://www.Environmental+planning+model+for+cultural+heritage+sites+in+Southeast+Europe%20(1).pdf). [e qasur më 20 nëntor 2019].

### 3.7 Palët e interesit

"Qasja e bazuar në komunitet" (rëndësia e së cilës manifestohet si një nga "Objektivat Strategjikë" të Trashëgimisë Botërore - "5 C")<sup>32</sup> do të thotë që koncepti i personave të interesuar ose palëve të interesit është i gjerë dhe gjithëpërfshirës. Palë e interesit është individ i ose grupi që ka pronësi ose interes legjitim dhe mund të ndikojë në ruajtjen dhe menaxhimin e objektit, si dhe të gjithë ata që shprehin interesim në trashëgiminë kulturore që nuk ka pse të bazohet në të drejtat pronësore ose të përfitojë drejtpërdrejt nga trashëgimia.<sup>33</sup>

Ilustrim 6: Palët e interesit si pjesë e menaxhimit të trashëgimisë kulturore

Palët e interesit mund të kenë nivele të ndryshme të interesit dhe nivele të ndryshme të përfshirjes, si dhe eventualisht edhe interesa të kundërta. Niveli i rëndësisë së palëve të interesit varet nga vlerësimi i potencialit të tyre qoftë në kontribuimin në procesin e menaxhimit ose në bllokimin e tij. Grafiku ilustrues më




32 Komiteti i Trashëgimisë Botërore miratoi në vitin 2002 (ndryshuar e plotësuar në vitin 2007) objektivat strategjike për zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore. Këto objektiva (të referuara gjithashtu si "5 C") janë kriteret në vijim: 1. Forcimi i **Besueshmërisë** së Listës së Trashëgimisë Botërore; 2. Sigurimi i **Konzervimit** efektiv të pronave të trashëgimisë botërore; 3. Promovimi i zhvillimit të **Ndërtimit të kapaciteteve** efektive në Shtetet Palë; 4. Rritja e ndërgjegjësimit, përfshirjes dhe mbështetjes për trashëgiminë botërore përmes **komunikimit**; dhe 5. Përmirësimi i rolit të **Komuniteteve** në zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore (shiko Paragrafin 26, *Udhëzimet Operative për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore (Udhëzimet Operative 2019)*, (Paris: UNESCO, Komiteti i Trashëgimisë Botërore dhe Qendra e Trashëgimisë Botërore, 2019), <https://whc.unesco.org/archive/opguide05-en.pdf>. [qasur më 12 shkurt 2020]

33 Shih Paragrafin 12, *Udhëzimet Operative për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore (Udhëzimet Operative 2019)*, (Paris: UNESCO, Komiteti i Trashëgimisë Botërore dhe Qendra e Trashëgimisë Botërore, 2019), <https://whc.unesco.org/archive/opguide05-en.pdf> [qasur më 12 shkurt 2020].

sipër jep një listë të palëve të interesit të zakonshme dhe i strukturon ato në përputhje me rëndësinë e tyre për procesin e menaxhimit.

Nevojat e ndryshme të gamës së gjerë të palëve të interesit duhet të njihen dhe integrohen në PMTK. Hapi i parë i punës me palët e interesit duhet të jetë identifikimi i tyre dhe vlerësimi i rolit të tyre. Konfliktet dhe interesat e kundërta midis palëve të interesit zgjidhen përmes shpjegimeve, diskutimeve, moderimeve dhe bashkëpunimit. Rezultati i punës së suksesshme me palët e interesit është që të gjithë ata t'i konsiderojnë objektivat si qëllime të tyre që korrespondojnë me interesat e tyre. Për të ilustruar rezultatin e pritshëm të punës me palët e interesit – pajtimin e interesave që bien ndesh dhe ndryshojnë nga njëri tjetri – mund të përdoret grafiku i mëposhtëm:



Ilustrimi 7: Pajtimi i nevojave të ndryshme dhe shpesh kundërshtuese të palëve të interesit gjatë procedurës së hartimit të planit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

Një udhërrëfyes i mundshëm për të identifikuar dhe vlerësuar palët e interesit është si vijon:



Ilustrimi 8: Shembull i një harte të rruges për të identifikuar dhe vlerësuar palët e interesit

Vlerësimi i palëve të interesit duhet të rezultojë në të kuptuarit e nivelit të autoritetit, përgjegjësisë dhe llogaridhënies që ato e kanë.

Në përputhje me atë, palët e interesit mund të klasifikohen si:

1. Palë që ndikojnë drejtpërdrejt në plan qoftë përmes kundërshtimit të trashëgimisë, kontribuimit për të, ose përmes përfitimit nga ajo;
2. Neutrale, por të interesuara për planin - mund të kontribuojnë në shkëmbimin e informacionit dhe ndërgjegjësim;
3. As me ndikim, dhe as të rëndësishme për procesin.

Modeli i planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore që do të prezantohet dhe promovohet në Kosovë përmes pilot rastit të simulimit është inovativ. Plani është negociuar dhe hartuar në të gjitha fazat e tij nga palët kryesore të interesit nën drejtimin dhe koordinimin e ekspertit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Palët e interesit duhet të marrin përsipër përgjegjësi për ta bërë procesin për planifikim të menaxhimit të trashëgimisë kulturore me bazë në komunitet.

Përveç faktit se palët e interesuara përfaqësojnë burim të mirëfilltë informacioni, kjo metodë jep një ndjenjë të pronësisë dhe përgjegjësisë për të gjithë procesin, gjë që çon në pritje që plani të zbatohet në mënyrë efektive. Vlera thelbësore e metodës është që do të krijohet një rrjet i fortë njerëzish që kanë interesa të përbashkëta në objektin e trashëgimisë kulturore me të kuptuar dhe shpërndarje të qartë të kapaciteteve dhe përgjegjësive të individëve nga radhët e tyre. Në vend të informimit, komunikimit dhe bashkëpunimit si metoda të integritit të palëve të interesit në procesin e planifikimit të trashëgimisë kulturore, në kontekstin e këtij manuali është zgjedhur qasja e punës ekipore me palët e interesit. Kjo metodë përfaqëson qasje plotësisht inovative; zbatimi i saj do të ofronte mundësi të rrallë për të aplikuar një koncept shumë të përparuar dhe të azhurnuar; për aq sa kemi marr informacioni rreth përvojave të ndryshme të planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Është dizajnuar për kontekstin e veçantë në Kosovë.

Ajo mund të shërbejë si mjet për krijimin e besimit të ndërsjellë midis palëve të interesit, dhe gjithashtu rrit nivelin e zbatimit të planeve të menaxhimit.




Procesi i planifikimit shërben edhe si mjet për ndërtimin e kapaciteteve, ku palët e interesit janë në gjendje të ngrisin kapacitetet e përfituesve. Ky fakt është domethënës për Kosovën për shkak të nevojës së vazhdueshme për të ngritur kapacitetet dhe për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e mbrojtjes së integruar të trashëgimisë kulturore.

**Procesi përgatitor dhe një kuptim i mirëfilltë i kontekstit në secilin rast, kanë një rëndësi thelbësore për suksesin e procesit.**

Planifikimi fillon pasi të jetë identifikuar objekti, të jetë formuluar vizioni dhe vlerësuar palët e interesit. Vlerësimi i palëve të interesit, megjithëse kërkon kohë, është me rëndësi thelbësore për suksesin e përfshirjes së tyre në procesin e hartimit që nga fillimi.





## 4. Faza e parë e planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore - faza e identifikimit

Faza e parë e procesit të planifikimit është faza e gjetjes së fakteve ose e identifikimit. Aktivitetet kryesore lidhen me mbledhjen dhe sistematizimin e të gjitha fakteve që kanë të bëjnë me objektin e trashëgimisë. Të dhënat grumbullohen përmes hulumtimit në zyrë dhe metodave në vend/objekt.



Gama e metodave të hulumtimit në zyrë përfshin mbledhjen e të gjitha dokumenteve arkivore, duke përfshirë hartat, projektet, vizatimet, përshkrimet, analizat, fotografitë nga faza të ndryshme të objektit të trashëgimisë kulturore, raportet mbi konservimet ose punimet kërkimore, raportet për mostrat, të gjitha faktet historike, të gjitha të dhënat në lidhje me pronësinë, regjistrin e tokës, veçoritë gjeografike, gjeomorfologjike, materialet, ndërtimet, etj.

Metoda në vend/objekt përbëhet nga regjistrime të njohësve (foto, regjistrime video, skica 3D), regjistrime paraprake (matja dheurvejimi me dorë) të cilat përfshijnë gjendjen siç është ndërtuar, gjendjen siç është gjetur, shenjat e përkeqësimit (çarjet, humbja e suvasë, bimët, etj.), dhe regjistrimin e detajuar i cili mund të përbëhet nga regjistrime metrike fotogramike, skanime laserike, etj. Kjo fazë merr shumë kohë dhe energji. Faktet nuk analizohen; ato thjesht përshkruhen dhe prezantohen.

Faza e identifikimit përmban identifikimin e objektit, historinë e shkurtër, përshkrimin e objektit të trashëgimisë dhe mund të përfshijë edhe përshkrimin e përcaktimeve ligjore dhe kontekstin e politikave, kontekstin ekzistues të menaxhimit, kërcënimet specifike, etj.

## 4.1 Identifikimi i objektit

Identifikimi i një objekti i ka dy përbërës, identifikimin e kategorisë së objektit të trashëgimisë dhe identifikimin hapësinor dhe sasior.

Kategoria e objektit, në përputhje me nenin 1 të *Konventës së Trashëgimisë Botërore*, mund të jetë: monument, ansambël arkitektonik, grup ndërtesash, vend arkeologjik dhe peizazh kulturor. Neni 2 i ligjit të trashëgimisë kulturore<sup>34</sup> përcakton listën e kategorive të trashëgimisë, si vijon:

2.1. "Trashëgimi kulturore" përfshin trashëgiminë arkitekturale, trashëgiminë arkeologjike, trashëgiminë e luajtshme dhe trashëgiminë shpirtërore.

2.2. "Trashëgimi arkitekturale" përbëhet nga:

a). Monumentet [...]

b). Ansamblet e ndërtesave: Grupet e ndërtesave urbane ose rurale [...]

c). Fushat e konservimit arkitektonik: Fushat që përmbajnë punë të kombinuara të dorës së njeriut dhe natyrës, të dalluara nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, shkencore, të interesit shoqëror dhe teknik. [...]

2.4. "Pejsazhet kulturore" nënkupton një fushë, ashtu siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i të cilës është rezultat i veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë; një komponentë esenciale e ambientit të njerëzve, një shprehje e diversitetit të trashëgimisë së përbashkët të tyre kulturore e natyrore, dhe një krijues i identitetit të tyre.

---

<sup>34</sup> Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore 1 korrik 2008.

Objekti duhet të ketë referencë në hapësirë në kuptimin që kufijtë dhe vendndodhja e tij të janë përcaktuar saktësisht. Identifikimi hapësinor duhet të përbëhet nga:

- Përshkrimi i vendndodhjes së përgjithshme dhe kontekstit gjeografik me harta dhe të dhëna kadastrale;
- Theksimi i komunës përkatëse dhe subjekteve tjera administrative, (p.sh. Qyteti, rrethi) me hartë;
- Kufijtë e zonës së mbrojtur (parametri);
- Kufijtë e zonës së mbrojtur (zona tampon);

Zona e mbrojtur është zona kontaktuese (e përcaktuar në hektarë ose metra katrorë, me kufij të përcaktuar saktësisht) të pasurisë së trashëgimisë së caktuar (të mbrojtur). Mekanizmi i kontrollit është vendosur në zonën tampon për të parandaluar zhvillimin e pakontrolluar i cili mund të ulë ose të kërcënojë vlerat e zonës së mbrojtur.

- Hollësitë mbi pronësinë të marra nga librat e regjistrit të tokës (regjistri kadastral) dhe shpjegimi i pronësisë. Objekti i trashëgimisë, i cili përbëhet nga disa pjesë përbërëse (i përbërë nga më shumë se një zonë), mund të kërkojë nivele të ndryshme të mbrojtjes për pjesët individuale. Përkatësisht, nganjëherë ekzistojnë disa komponentë të veçantë të objektit ku mund të lejohen vetëm hulumtime, ruajtje dhe prezantim, ndërsa në komponentët e tjerë lejohen aktivitete restauruese, apo edhe rindërtim dhe ripërdorim i përshtatur etj. Në Kosovë, është e rëndësishme gjithashtu të merren në konsideratë dispozitat e *Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura*<sup>35</sup> si dhe kufijtë e një zone të veçantë të mbrojtur - në rast se përfshihet në objektin e trashëgimisë ose në rast se e përfaqëson atë objekt.

## 4.2 Historia

Pasqyrimi historik është i rëndësishme për analizat e vlerave, autenticitetit dhe integritetit, si dhe për të kuptuar trendet e ndryshimeve në objekt. Pasqyrimi historike duhet të jetë gjithëpërfshirës, jo shumë i gjatë dhe i qartë. Pasqyrimi historik duhet të jepet për objektin e trashëgimisë kulturore në mënyrë gjithëpërfshirëse, si dhe për secilën nga pjesët përbërëse të tij sipas rendit kronologjik. Ai duhet të përshkruaj historinë e objektit përgjatë hapësirës kohore, kontekstin historik në lidhje me faktet politike dhe shoqërore, ndodhjen e fatkeqësive natyrore dhe atyre të bëra nga njerëzit, ndryshimet që kontribuan

---

35 Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e veçanta të mbrojtura, 4 qershor 2008.

në formimin e objektit, ndryshimet që ndikuan në autenticitetin dhe integritetin e objektit, dhe çështje tjera të rëndësishme. Pasqyrimi historik duhet të bazohet në burimet përkatëse shkencore, gjetjet arkeologjike, hartat historike, si dhe në fakte relevante e të provuara shkencërisht. Pasqyrimi historik duhet të jetë edhe gjithëpërfshirës. Historia e hulumtimeve dhe ruajtjes së komponentëve të objektit të trashëgimisë kulturore kontribuon si pjesë e rëndësishme dhe konkluzive e pasqyrimin historik. Pasqyrimi historik duhet të strukturohet si vijon: prezantim i shkurtër i historisë përkatëse sociale, politike dhe kulturore, ngjarjeve të rëndësishme historike ose i personave të rëndësishëm historikë të lidhur me objektin, kronologjia e përdorimit të hapësirës, kronologjia e ndërtimit dhe kronologjia e peizazhit nëse është relevante. Për më tepër, vendi duhet të paraqitet në lidhje me historinë e tij të përdorimit dhe funksionit, historinë e shtesave eventuale të zëvendësimeve ose heqjeve të komponentëve të rëndësishëm, historinë e shkatërrimit dhe rrënimit, historinë e hulumtimit, historinë e mbrojtjes së tij ligjore dhe ruajtjes së tij, dhe atë në lidhje me faktet e tjera që eventualisht janë të rëndësishme.

### 4.3 Përshkrimi

Përshkrimi është pjesë e fazës së identifikimit të planit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore duke përdorur të gjitha të dhënat në lidhje me paraqitjen e të gjithë përbërësve të objektit në kontekstin e menaxhimit. Struktura e përshkrimit duhet të përfshijë, ndër të tjera:

- Përshkrimin e zonës gjeografike që mbrohet
- Gjeologjinë
- Topografinë
- Drenazhin
- Klimën
- Dheun
- Arkitekturën (bazamentin, funksionin, stilin, materialet, format, detajet, gjendjen e konzervimit)
- Arkeologjinë (bazamentin, funksionin fillestar, materialet, stilin, detajet, gjendjen e ruajtjes dhe prezantimit)
- Shprehjet jo-materiale të trashëgimisë
- Përdorimin e tokës përfshirë bujqësinë, pylltarinë, zhvillimin tregtar dhe aktivitetet sportive

- Bimësinë duke përfshirë kufijtë fushorë, tokat pyjore dhe llojet e habitatit
- Sondazhet dhe gjetjet e ekspertëve
- Degradimin
- Funksionet e tanishme dhe ato të mëparshme
- Zonat e kontaktit
- Legjislacionin e zbatueshëm dhe kontekstin e menaxhimit
- Rreziqet (natyrore dhe njerëzore)
- Hartat, vizatimet, etj. të përfshira

Përshkrimi gjithnjë bëhet duke ndjekur metodën nga e përgjithshmja deri te hollësitrat, nga jashtë brenda.

1. Përshkrimi fillon me pozitën e vendit në zonë më të gjerë, që përfshin hartat, ndjekur nga përshkrimi i marrëdhënieve të tij me strukturat fqinje (përfshinë hartat);
2. Shqyrtimi i përshkrimit në dokumentet arkivore ose në botimet e vjetra;
3. Informacioni i përgjithshëm për llojin e objektit, dimensionet e tij dhe organizimin hapësinor, materialin dhe strukturën e tij, tregimet dhe asocimet e paprekshme, materialet kryesore të tij (planet, pjesët dhe prezantimet 3D dhe mostrat e materialeve të përfshira);
4. Përshkrimi i një peizazhi kulturor ose ansambli duhet të identifikojë të gjithë përbërësit e objektit dhe hartën e tyre, dhe duhet të marrë parasysh kompleksitetin e objektit gjatë përpilimit të përshkrimit në një mënyrë të qartë dhe të menaxhueshme;
5. Strukturat (në rast se një objekt është i përbërë nga komponentët arkitektonikë) e themeleve, mureve, çative, elementeve karakteristike strukturore (kolonave, skelave, harqeve, kupolave, kubeve, etj.);
6. Fasadat, muret e jashtme, hyrjet, fenestrimi (fotot, skicat me shënime, vizatimet me shkrime dore, vizatime të hollësishme - LIDAR,<sup>36</sup> fotografitë e rregulluara, etj; për mostrat e materialeve të përfshira);

<sup>36</sup> LIDAR është shkurtesë e "zbulimit të dritës dhe renditjes" dhe përdoret si emër për skanimin e objektit 3D (skanimin me laser). Objekti që duhet të regjistrohet është ndriçuar me laser pulsues. Pulset e pasqyruara nga kunjat në objekt maten me sensorë. Dallimet në kohën e kthimit të laserit mundësojnë bërjen e paraqitjes 3D të saktë digjitale të objekteve.

7. Pamjet ajrore dhe të çatisë (ortofotografisë, <sup>37</sup> fotot ajrore, <sup>38</sup> skicat me shënime, <sup>39</sup> vizatimet e shënimeve me dorë, vizatimet e hollësishme – skanimet laserike, fotografisë e rregulluara, <sup>40</sup> etj.);
8. Organizimi i brendshëm (planet, detajet; për përshkrimin e mostrave të materialeve të përfshira);
9. Përshkrimi, përbërësit me përbërës; hapësirat me hapësira: dimensionet, struktura, dyshemetë, muret, tavanet, shtyllat, kolonat, kupolat (përfshin materialet, teknikat, ngjyrat, etj.) fotot, skicat me shënime, vizatimet e shënimeve me dorë, vizatimet e hollësishme – skanimet laserike, fotografisë e rregulluara; marrjen e mostave, <sup>41</sup> etj.);
10. Dyert, dritaret – fotografisë, skicat me shënime, vizatimet e shënimeve me dorë, vizatimet e hollësishme – skanimet laserike, fotografisë e rregulluara, etj.);
11. Përshkrimi i ndryshimeve, humbjeve, dëmtimeve dhe nivelit të përkeqësimit;
12. Shprehjet jo-materiale duhet të përshkruhen me informacion të plotë mbi llojin e tyre, mënyrën dhe kohën e shprehjes, përcaktimin stilistik, transportuesit dhe mirëmbajtësit e tyre, duke përfshirë lidhjen e tyre me vendin, etj.;
13. Fakte tjera të rëndësishme.

---

37 Ortofotografia (ortofoto ose orthoimazh) është fotografi ajrore, e cila korrigjohet gjeometrisht, në atë mënyrë që shkalla të jetë uniforme, ashtu që të mund të përdoret si hartë për të matur distancat. Korrigjimi gjeometrik i shtrembërimit të fotografisë quhet ortorektifikim.

38 Fotografisë ajrore të një vendi merren nga një objekt fluturues. Më së shpeshti, një ose më shumë kamera janë fiksuar në pjesën e poshtme të jashtme të një aeroplani, helikopteri, ose ndonjë mjeti ajror pa pilot (droni), megjithëse objekte të tjera fluturuese, madje edhe pëllumba, kanë shërbyer për imazhe ajrore.


39 Skica me shënime është vizatim i punuar me dorë që është rezultat i një vëzhgimi, kuptimi dhe interpretimi personal të vendit, me sa më shumë informacione që është e mundur. Karakteristikat kryesore të regjistruara gjatë këtij procesi janë: madhësia e përafërt e ndërtesave dhe veçoritë tjera, marrëdhënia e tyre hapësinore, materialet e përdorura në ndërtimin e tyre, ku është e mundur, renditja në të cilën janë ndërtuar ose ndryshuar, dëmtimet dhe përkeqësimet, detajet, etj. Informacioni jepet në formën e shënimeve të lidhura me shigjeta në skicë.

40 Fotografia e rregulluar përdoret zakonisht për fasadat. Ajo siguron imazh të sheshtë pa shtrembërime të mundshme gjeometrike. Dallimi midis ortorektifikimit dhe fotorektifikimit është se ortofoto është imazh stereo, ndërsa fotografia e rregulluar është imazh planar.

41 Marrja e mostrave është akti i heqjes së përhershme të sa më pak pjesëve të mundshme të materialit nga materiali i ndërtimit për qëllime të karakterizimit ose analizës së materialit, karakteristikave kimike dhe fizike të tij, moshës së tij, gjendjes së tij, etj.



Përshkrimi i një vendi duhet të sigurojë të gjitha detajet në lidhje me vendin në gjendjen "siç është gjetur", me referencë të qartë kronologjike - koha e ndërtimit të një elementi të caktuar të vendit duhet të përmendet gjithmonë. Përcaktimi kronologjik bëhet në vizatime sipas ngjyrës dhe legjendës. Materialet duhet të hartohen në vizatime. Mënyra më e dobishme për të krijuar përshkrim të qartë dhe të kuptueshëm të vendeve shumë komplekse është strukturimi i përshkrimit sipas fushave të veprimit. Kjo qasje do të ofrojë prezantim të qartë të gjendjes fillestare të të gjitha fakteve më të rëndësishme në lidhje me objektin, përfshirë gjendjen aktuale të ruajtjes dhe gjendjen e menaxhimit.



Ilustrimi 9: Shembull i një plani të rrënojave të një kështjelle me referenca kronologjike të fazave të ndërtimit, duke filluar nga mesi i shekullit 11 (e verdhë) deri në shekullin 20 (e gjelbër) (në: [https://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/7/76/Burg\\_Raabs\\_neu.jpg](https://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/7/76/Burg_Raabs_neu.jpg))

Është e rëndësishme që të aplikohet qasje sistematike për prezantimin e rreziqeve, dëmeve dhe përkeqësimeve (t'i bashkëngjiten foto, vizatime, skica me shënuara).


Si pikë fillestare për vlerësim të rrezikut, rreziqet dhe dëmet duhet të klasifikohen duke marrë parasysh natyrën e të dyjave: llojin e përbërësit (natyror, arkitektonik, arkeologjik, të luajtshtëm dhe të paprekshëm) dhe llojin e ndikimit (faktori ndikues), për shembull:

- Fatkeqësitë natyrore si rrëshqitjet e dheut, përmbytjet, erat e forta, ortekët, tërmeti, cunami, zjarri;
- Erozioni;
- Gropat si pasojë e gjurmimeve të paligjshme;
- Humbja e elementeve strukturore ose pjesëve të tyre;
- Depozitat e kristalizuara të kripërave në masoneri (kripërimi);
- Deformimet e elementeve strukturore ose dekorative;
- Frakturat;
- Çarjet;
- Deponitë e ngritura;
- Rrjedhje në hidraulikë dhe rrjedha në çati dhe ulluqe;
- Lagështia e brendshme si pasojë e kondenzimit të ngopur;
- Prishja e suvatimit;
- Korrozioni;
- Ndryshku;
- Kërpudhat;
- Bimët shkatërruese;
- Etj.

Dëmet dhe kërcënimet duhet të paraqiten në mënyrë sistematike për sa i përket vendndodhjes dhe llojit të tyre, si dhe duhet të vendosen në hartë në vizatime. Është e rëndësishme të theksohet se përshkrimi duhet të personalizohet për të pasqyruar natyrën e objektit dhe kontekstin e tij specifik fizik.

Thënë shkurt, përshkrimi përfshin të gjithë dokumentacionin e objektit, përbërësit e tij, kontekstin, natyrën, arkeologjinë, infrastrukturën, arkitekturën, strukturën, materialet dhe detajet. Ai paraqitet përmes të gjitha regjistrimeve (foto, video, skica 3D, foto ajrore), dokumentacionit paraprak (regjistrime me dorë, skica të shënuara, vizatime teknike, etj.), si dhe regjistrimeve të hollësishme që janë rezultat i kombinimit të regjistrimeve me dorë dhe fotogrametrisë, skanimit laserik, ortofotografisë, fotografisë së rregulluar tokësore, etj.; të gjitha gjetjet në lidhje me strukturën (foto, vizatime, etj.); të gjitha gjetjet në lidhje me materialet (rezultatet e marrjes së mostrave, fotot, etj.); të gjitha gjetjet në lidhje me menaxhimin.






## 5. Faza e dytë e planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore - faza e analizës / vlerësimit

Faza e parë e planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore është faza që merr më së shumti kohë, energji dhe burime njerëzore. Identifikimi i saktë i gjendjes fillestare të objektit është me rëndësi thelbësore për një fazë të dytë të suksesshme.

Faza e dytë e planifikimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore është më e vështira, në kuptim të ekspertizës. Analizat e realizuara gjatë fazës së dytë ofrojnë konkurrën e objektivave specifike dhe planit të veprimit.

Kjo është faza në të cilën të gjitha të dhënat e mbledhura dhe të sistematizuara gjatë fazës së identifikimit përpunohen duke ndjekur metodat dhe kriteret e përcaktuara dhe të përshtatura sipas objektit. Gjatë fazës së vlerësimit, duhet të merren në konsideratë sfida të shumta të trashëgimisë kulturore, disa prej tyre universale, dhe të tjera specifike dhe lokale.



Ilustrim 10: Gjatë fazës së vlerësimit të hartimit të një plani të menaxhimit, duhet të merren parasysh shumë aspekte - shpeshherë divergjente.

Duhet të vlerësohen katër komponentët kryesorë të mëposhtëm: 1. Rëndësia - vlerat, autenticiteti dhe/ose integriteti; 2. Gjendja e konservimit (KOS); 3. Menaxhimi aktual; 4. Rreziqet.

Metoda e analizës SWOT është vërtetuar të jetë e përshtatshme për menaxhimin e trashëgimisë kulturore, megjithëse mund të përdoren edhe metoda të tjera.

## 5.1. Vlerësim i rëndësisë - Vlerat, autenticiteti dhe/apo integriteti

### 5.1.1 Përcaktimi i vlerës

Vlera ka qenë gjithmonë ide udhëzuese e mbrojtjes së trashëgimisë. Njerëzit mbrojnë dhe ruajnë atributet që kanë vlera të brendshme (të përhershme, të pandryshueshme) ose instrumentale (të ndërtuara, përdoruese). Diskutimet mbi vlerat dhe vlerësimin e tyre janë të shumta dhe ndonjëherë shumë të ndryshme që nga botimi i librit të famshëm “Kulti Modern i Monumenteve: Karakteri dhe origjina e tij” nga Alois Riegl më 1903<sup>42</sup>.

Randal Mason sugjeron që në kohët bashkëkohore, vlerat e trashëgimisë shërbejnë për t'i qartësuar çështjet e planifikimit të konservimit dhe menaxhimit të trashëgimisë; për më tepër, qasja e bazuar në vlera rrit efektivitetin e të dy aktiviteteve.<sup>43</sup> Tutje, Mason argumenton se në secilin rast specifik, tipologjitë e vlerave të trashëgimisë duhet të identifikohen në varësi të konteksteve të ndryshme sociale, politike dhe ekonomike dhe kornizave tradicionale. Ai paraqet një tipologji

preliminare të vlerave të trashëgimisë që nuk janë as ekskluzive, as shteruese për ta bërë atë të përdorshme për udhëzimet për vlerësimin të trashëgimisë. Ai i klasifikon vlerat në dy lloje: 1) vlerat socio-kulturore dhe 2) vlerat ekonomike.

Vlerat socio-kulturore	Vlerat ekonomike
Historike Vlerat edukative/akademike Vlera artistike, etj.	Vlera e përdorimit (tregut) Tarifat e hyrjes në një monument historik Kostoja e tokës Pagat e punonjësve
Kulturore /simbolike Vlera artizanale ose e lidhur me punën Vlera politike	Vlerat e mospërdorimit (jo e tregut) Ekzistenca
Sociale Shtojca hapësinore Cilësitë e hapësirës së përbashkët	Opsion Trashëgimi
Shpirtërore/fetare	
Estetike	

Ilustrimi 11: Tabela e vlerave të trashëgimisë në kornizën e qasjes së bazuar në vlera, sipas Randal Mason.

42 Riegl, A., “Kulti Modern i Monumenteve: Karakteri dhe origjina e tij (Moderner Denkmalkultus: sein Wesen und seine Entstehung).” *Kundërshtimet*, Vjeshtë 1982, botimi 25, faqe 21-51.

43 Mason, R., “Vlerësimi i vlerave në planifikimin e konservimit: Çështjet dhe zgjedhjet metodologjike”, në: M. d. I. Torre (bot.), *Vlerësimi i vlerave të trashëgimisë kulturore*

(*Raport hullumtues*), (Los Angeles: Instituti i Konservimit Getty, 2002), f 5-31, [https://www.getty.edu/conservation/publications\\_resources/pdf\\_publications/pdf/assessing.pdf](https://www.getty.edu/conservation/publications_resources/pdf_publications/pdf/assessing.pdf) [qasur më 20 shkurt 2020].



Sidoqoftë, shumica e autorëve ende konsiderojnë se llojet e vlerave socio-kulturore kanë rëndësi parësore në procesin e vlerësimit. Por, planet për menaxhimin e trashëgimisë kulturore duhet të marrin parasysh vlerën ekonomike të trashëgimisë, praktikat më të mira, si dhe analizat e kostos-efektit që konfirmojnë ndikimin në zhvillimin e trashëgimisë. Disa studime të kohëve të fundit saktësojnë ndikimin pozitiv të konservimit dhe rehabilitimit të trashëgimisë dhe përcaktojnë konservimin dhe rehabilitimin e trashëgimisë si gjenerues të vendeve të punës dhe punësimit, të ardhurave dhe fitimit financiar.<sup>45</sup>

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të qëndrueshëm. Siç përcaktohet në *Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030* të KB (SDG 2030) aktivitetet duhet të synojnë "forcimin e përpjekjeve për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore në botë."<sup>46</sup> Ky synim duhet të shihet në lidhje me Objektivin e SDG "që t'i bëjë qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurt, të forta dhe të qëndrueshme". (Synimi 11, SDG 2030). Qytetet e sigurt konsiderohen si një nga gurthemet për të siguruar një botë pa varfëri (ose së paku varfëri të zvogëluar) dhe me drejtësi sociale. Në lidhje me dimensionin shoqëror të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, mirëqenia sociale mund të njihet bazuar në shembuj të vendeve të trashëgimisë industriale. Kur një kompleks industrial fillon të mos nxjerrë më fitime dhe të ndalojë kontributin e tij për një rol zhvillimi në komunitet, ekziston rrezik i madh që objekti të preket nga papunësia, depopullimi, gjentrifikimi dhe margjinalizimi. Menaxhimi i integruar i trashëgimisë industriale i shmang ato rreziqe<sup>47</sup>.

Studimet e përmendura konfirmojnë se një qasje me fokus në njerëz, e bazuar në vend dhe e përshtatur sipas politikave të zhvillimit të territorit, ofron zgjidhjet më premtuese të zhvillimit të qëndrueshëm. Vlerat rriten nëse objekti paraqet shembull të rrallë ose të veçantë të një lloji, stili, dokumenti, zgjidhjeje strukturore, etj.



---

45 Anglia Historike, *Trashëgimia ka vlerë 2017: Trashëgimia dhe Ekonomia* (Londër: Anglia Historike, 2017), <https://content.historicengland.org.uk/content/heritage-counts/pub/2017/heritage-and-the-economy-2017.pdf> [qasur më 20 nëntor 2019].

46 Shihni synimin 11.4, *Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të KB (SDG 2030)* (2015), <https://sustainabledevelopment.un.org/> [qasur më 14 nëntor 2019].

47 Landorf, C., "Kornizë për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Trashëgimisë: Studim i monumenteve të Trashëgimisë Industriale në Mbretërinë e Bashkuar", *Journal International of Heritage Heritage*, Botimi 15:6 (2009), f. 494-510.



### 5.1.2. Autenticiteti dhe/ose Integriteti

Testi i autenticitetit bëhet për objektet e trashëgimisë kulturore. Gjersa është gjithashtu e rëndësishme të adresohet integriteti i objekteve të trashëgimisë kulturore, integriteti është testi i vetëm që aplikohet për objektet natyrore ose përbërësit natyrorë të një peizazhi kulturor.

#### **Autenticiteti**

Autenticiteti është masë e vlerës. *Udhëzimet Operative* të Konventës së Trashëgimisë Botërore përmbajnë dispozita në lidhje me provën e autenticitetit që bazohen në “Dokumentin Nara mbi Autenticitetin”:

*“Konservimi i trashëgimisë kulturore në të gjitha format dhe periudhat e saj historike është i mishëruar në vlerat që i atribuohen trashëgimisë. Aftësia jonë për t’i kuptuar këto vlera pjesërisht varet nga shkalla në të cilën burimet e informacionit për këto vlera mund të kuptohen si të besueshme ose të vërteta. Njohuria dhe të kuptuarit e këtyre burimeve të informacionit, në lidhje me karakteristikat origjinale dhe të mëvonshme të trashëgimisë kulturore dhe kuptimin e tyre, është bazë e nevojshme për të vlerësuar të gjitha aspektet e autenticitetit.”<sup>48</sup>*

Është e rëndësishme të mbahen në mend vlerat kur të bëhet prova e autenticitetit. Kushti i autenticitetit përmbushet kur vlerat kulturore shprehen me vërtetësi dhe besueshmëri përmes një game të gjerë atributesh (paragrafi 82, *Udhëzimet Operative 2019*) si:

- Forma dhe dizajni
- Materiali dhe substancë
- Vendndodhja dhe vendosja
- Përdorimi dhe funksioni
- Traditat, teknikat, gjuha dhe shprehjet e tjera të trashëgimisë jomateriale

---

48 See paragraph 9, Nara Document on Authenticity (Paris: ICOMOS, 1994), <https://www.icomos.org/charters/nara-e.pdf> [accessed 4 November 2019].

- Fryma dhe ndjenjat.<sup>49</sup>

## **Integriteti**

Gjithashtu, nocioni i integritetit është ndikuar kryesisht nga Trashëgimia Botërore:

*“Integriteti është një masë e tërësisë dhe e paprekshmërisë së trashëgimisë natyrore dhe/ose kulturore dhe attributeve të saj. Prandaj, ekzaminimi i kushteve të integritetit kërkon vlerësimin e asaj se në çfarë shkalle prona: a) përfshin të gjithë elementët e nevojshëm për të shprehur vlerën e jashtëzakonshme universale; b) është i madhësisë së përshtatshme për të siguruar përfaqësim të plotë të tipareve dhe proceseve që përcjellin rëndësinë e pasurisë; c) vuan nga efektet negative të zhvillimit dhe/ose lënies pas dore.” (paragrafi 88, Udhëzimi Operativ 2005)<sup>50</sup>.*

Niveli i autenticitetit mund të jetë i lartë ndërsa niveli i integritetit i ulët, ose niveli i integritetit mund të jetë i lartë, por niveli i autenticitetit mund të jetë shumë i ulët.<sup>51</sup>

## **5.2 Gjendja e Konservimit**

Gjendja e konservimit jep një pamje gjithëpërfshirëse të të gjitha aspekteve që janë të lidhura me menaxhimin e trashëgimisë kulturore të një objekti të veçantë. Është rezultat i analizave të të gjitha të dhënave të mbledhura gjatë fazës fillestare. Duke pasur parasysh kompleksitetin e shumicës së objekteve në Kosovë për të cilat është parashikuar plan

---

49 Shih paragrafin 82, Udhëzimet Operative për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore (Udhëzimet Operative 2019), (Paris: Komiteti i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe Qendra e Trashëgimisë Botërore, 2019), <https://whc.unesco.org/archive/opguide05-en.pdf> [qasur më 12 shkurt 2020].

50 Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention, (Operational Guidelines 2005), (Paris: UNESCO World Heritage Centre and World Heritage Committee, 2005), <https://whc.unesco.org/archive/opguide05-en.pdf> [accessed 24 October 2019].

51 Për autenticitetin dhe integritetin, shihni Jokilehto, J., “Konsideratat mbi autenticitetin dhe integritetin në kontekstin e trashëgimisë botërore”, *Qyteti & Koha*, Botimi 2 (1):1 (2006), f 1-16, URL: <http://www.ct.ceci-br.org> [qasur më 14 nëntor 2019].

menaxhimi i trashëgimisë kulturore - ansambleve të komplekseve, grupeve të ndërtesave, bërthamave historike ose peizazheve kulturore - analizat duhet të bëhen duke kombinuar dy metoda - Analizë SWOT për fushë të veprimit.

### 5.2.1 Fushat e veprimit

Identifikimi i fushave të veprimit është rezultat i fazës fillestare të analizave. Fushat e veprimit paraqesin grupet më të rëndësishme të planifikimit. Identifikimi i tyre korrespondon me qëllimet e përgjithshme, dhe reflekton natyrën, vlerën, gjendjen e objektit dhe kornizën strategjike. Fushat e veprimit në lidhje me çështjet e menaxhimit të identifikuara për secilin objekt specifik. Shembujt e fushave të zakonshme të veprimit janë si në vijim: Ndërtimi i kapaciteteve institucionale, konservimi, hulumtimi, edukimi, interpretimi, turizmi, menaxhimi i rrezikut, mbrojtja ligjore, etj. Fushat e veprimit mund të grupohen në tri lloje kryesore: 1. ato që mundësojnë qasje me fokus në njerëz; 2. ato që ofrojnë qasje të bazuar në vend; 3. ato që synojnë krijimin ose zbatimin e grupit të politikave të integruara të menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

Lista e fushave të veprimit varet nga kategoria e objektit, domethënia e objektit, gjendja e menaxhimit, gjendja fizike, konteksti politik, metodat tradicionale të mirëmbajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë. Metoda e fushave të veprimit siguron qasje gjithëpërfshirëse ndër-sektoriale. Sidoqoftë, është e rëndësishme të kihet parasysh se të gjitha veprimet, pa marrë parasysh në cilën fushë të veprimit, duhet të lidhen me qëllimet kryesore dhe të fokusohen drejt menaxhimit të qëndrueshëm dhe të integruar të trashëgimisë kulturore. Fushat e veprimit janë reciprokisht të ndërlidhura dhe të ndërvarura. Ndonjëherë, një fushë veprimi aplikohet për të siguruar veprime nga fusha tjetër, për të qenë e menaxhueshme - për shembull, për turizmin, mund të aplikohet fusha e veprimit trafiku dhe infrastruktura, ose për konservimin dhe rehabilitimin, mund të aplikohet fusha e veprimit masat gjeoteknologjike dhe stabilizimi i tokës.


Në rast se aplikohet metoda e fushave të veprimit, përshkrimi i zonës, menaxhimi aktual, gjendja e ruajtjes, si dhe rreziqet specifike, pra të gjitha ose disa nga komponentët kryesorë të vlerësimit, mund të paraqiten për secilën fushë të veprimit.



## 5.2.2 Analiza SWOT

Metoda SWOT është formuar fillimisht si metoda e analizimit të bizneseve dhe kompanive. Për dallim nga metodat e tjera të përdorura për analizë të kompanive, SWOT është metodë që lehtësisht përshtatet për qëllime të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Emri i kësaj metode është shkurtësë që përbëhet nga shkronjat e para të fjalëve që tregojnë kriteret e analizave: **s**-përparësitë, **w**-dobësitë, **o**-mundësitë, **t**-rreziqet.

Analiza SWOT paraqet nevojën për aktivitete të integruara me objektivat për të realizuar mundësi përmes përdorimit dhe avancimit të përparësive, si dhe zbutjes ose parandalimit të rrezikut dhe rregullimit të dobësive.




Përparësitë dhe dobësitë janë tipare të secilës fushë veprimi që mund të përkufizohen si të brendshme (faktorët e brendshëm shkaktojnë përparësi ose dobësi), ndërsa mundësitë dhe rreziqet janë faktorë që vijnë nga jashtë fushës së veprimit (të jashtme). Ana e majtë e tabelës më poshtë, pra përparësitë dhe mundësitë paraqesin listën e faktorëve që mbështesin planifikimin e suksesshëm të aktiviteteve, ndërsa ana e djathtë e tabelës përmban faktorët që pengojnë planifikimin e integruar të aktiviteteve.

Ilustrimi 13: metoda SWOT mbulon faktorët e brendshëm (të cilët shkaktojnë përparësi ose dobësi) dhe aspektet e jashtme (si mundësitë dhe rreziqet).



### 5.2.3 Vlerësimi i rrezikut

Gatishmëria e rrezikut duhet të jetë një fushë e detyrueshme veprimi për secilin objekt, pa marrë parasysh cilat janë karakteristikat specifike të objektit dhe konteksti i tij fizik, shoqëror, historik dhe ekonomik. Megjithatë, një vlerësim i hollësishëm dhe specifik i rrezikut mund të bëhet gjithashtu për secilën fushë të veprimit në mënyrë që të mundësohet planifikim i hollësishëm dhe specifik i gatishmërisë së rrezikut. Vlerësimi i rrezikut duhet të jetë relevant për objektin me të dhëna të sakta mbi rreziqet dhe cenueshmërinë.



Ilustrimi 14: Menaxhimi i rrezikut përfshin të tre fazat: para-, gjatë- dhe pas ndodhjes së fatkeqësive. Ky qark: parandalimi - zbutja - rimëkëmbja tregon detyrën e përhershme të menaxhimit të rrezikut meqë “pas-fatkeqësia është para fatkeqësisë”.

Vlerësimi i rrezikut duhet të bazohet në efektet njohëse të fatkeqësive natyrore dhe njerëzore; identifikimi i rreziqeve; matja e cenueshmërisë. Vlerësimi duhet të bëhet duke pasur parasysh tre skenarët: parandalimin përmes mirëmbajtjes dhe monitorimit (para rrezikut), masat zbutëse në rast fatkeqësie dhe rimëkëmbja pas shfaqjes së fatkeqësisë.

Për shkak të faktit se gatishmëria e rrezikut është studiuar gjerësisht gjatë dekadave të fundit, termat që përdoren në dokumentet zyrtare (siç është plani i menaxhimit të trashëgimisë kulturore) kanë përcaktim semantik konvencional: Është e rëndësishme të keni parasysh kuptimin specifik të fjalëve kyçe, siç janë fatkeqësia, rreziku, cenueshmëria dhe rreziku.

“Fatkeqësia” është shfaqja e fenomenit që shkakton humbje dhe dëmtim të trashëgimisë kulturore.

“Rreziku” është mundësia e shfaqjes, brenda një periudhe të caktuar, të katastrofave: aktivitet sizmik dhe vullkanik, përmytje, ortek, cunami, stuhi, zjarr, shpërthime, rrëshqitje të dheut, si dhe katastrofa teknike (bërthamore ose të ngjashme), sulme terroriste, aksidente në shkallë të gjerë, konflikte të armatosura, etj. Zakonisht rreziku kategorizohet në dy lloje kryesore: natyrore dhe njerëzore. Rreziqet natyrore janë moti, tërmeti, përmytja, rrëshqitjet e dheut, etj. Rreziqet e krijuara nga njeriu janë fatkeqësi teknike, vandalizmi, terrorizmi, lufta, presioni i zhvillimit, ndërtimet pa leje, trafiku, ndotja, zjarri, etj.

“Cenueshmëria” është shkalla e dëmtimit të një subjekti në rrezik për shkak të karakteristikave ose kushteve të tij. Për shembull, ndërtesat e muratosura janë më të cenueshme nga tërmeti sesa ndërtesat me kornizë druri, ndërsa ndërtesat me kornizë druri janë më të cenueshme nga zjarri sesa ndërtesat e muratosura; ose ndërtesat e qerpiçit janë më të cenueshme nga përmytja sesa ndërtesat prej guri; sa më e dobët gjendja e konservimit të objekteve dhe sa më i dobët të jetë menaxhimi, aq më e lartë është cenueshmëria ndaj çdo fatkeqësie. Ekzistojnë një sërë kriteresh për të vlerësuar cenueshmërinë, siç janë: sistemi strukturor, materiali, gjendja fizike, vendndodhja, pronësia, përdorimi, gjendja e mbrojtjes ligjore, ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe dispozitat e tyre specifike në lidhje me parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve, planifikimi hapësinor përkatës, politikat dhe dokumentet, dhe dispozitat e tyre specifike, autoritetet përgjegjëse, gjendja e konservimit, sistemi i interpretimit, politika e mirëmbajtjes, korniza financiare, monitorimi i gjendjes, kontrolli i rrezikut, inspektimi, etj.

“Rreziku” është kombinimi i rrezikshmërisë dhe cenueshmërisë.



Ekzistojnë tri lloje të rrezikut: ngjarje të rralla, ngjarje të zakonshme dhe procese kumulative.

- Ngjarjet e rralla ndodhin më rrallë se rreth një herë në 100 vjet (përmbytje, tërmete me dëme, zjarre të mëdha, vjedhje, etj.)
- Ngjarjet e zakonshme ndodhin shumë herë brenda shekullit (rrjedhje uji, rrëshqitje të tokës me dëme, zjarre të vogla, aksidenteve, vjedhje të vogla, etj.)
- Proceset kumulative mund të ndodhin vazhdimisht ose kohë pas kohe. Ngjarjet shumë të shpeshta mund të konsiderohen edhe si procese kumulative (gërryerja e metaleve, erozioni i gurit, kalbja e drurit, erozioni i tokës, etj.).

Menaxhimi i rrezikut është procesi që mbulon të gjitha fazat e menaxhimit të trashëgimisë kulturore, siç ilustrohet në grafikun e mëposhtëm.<sup>52</sup>

Ilustrimi 15: Menaxhimi i rrezikut kërkon qasje gjithëpërfshirëse duke marrë parasysh shumë aspekte që mund të shkaktojnë fatkeqësi ose që do të jenë pasojë e shfaqjes së tyre.



52 Për menaxhimin e rrezikut, shihni Pedersoli, J.L.J., Antomarchi, C., Michalski, S., *Udhëzues për menaxhimin e rrezikut të trashëgimisë kulturore. Botimi i parë* (Rome: ICCROM; Qeveria e Kanadasë - Instituti Kanadez i Konservimit, 2016), [https://www.iccrom.org/wp-content/uploads/Guide-to-Risk-Management\\_English.pdf](https://www.iccrom.org/wp-content/uploads/Guide-to-Risk-Management_English.pdf) [qasur më 12 nëntor 2019].

## 6. Faza e tretë – plani i veprimit

Plani i veprimit është pjesë thelbësore e planit për menaxhimin e trashëgimisë kulturore. Ai duhet të bazohet tërësisht në analiza.

Duhet sendërtuar një plan veprimi për fushën e veprimit dhe plani duhet përmbajë objektiva të veçanta, seri aktivitesh të dizajnuara për të arritur çdo objektivë të veçantë, dhe indikatorë monitorimi për çdo aktivitet të planifikuar. Aktivitetet duhet të jenë të afatizuara, por jo më qatë se 5 vjet.



## 6.1 Objektivat specifike

Objektivat specifike duhet të definohen për çdo fushë veprimi. Ato duhet të jenë të ndërlidhura me synimet kryesore dhe deklaratën e rëndësisë.

Metodat më së shpeshti të përdorura për vendosjen dhe strukturimin e objektivave njihen si SMART dhe CLEAR (ndërtuar me gërmat e para të fjalëve në gjuhën angleze):

Metoda SMART është metodë e mirënjohur dhe e provuar. Qëllimet duhet t'i arrijnë pesë kritere, gjegjësisht të jenë, si vijon:

- **Specifike;**
- **Matshme;**
- **Arritshme;**
- **Reale;**
- **Afatizuara.**


Metoda tjetër, pra **metoda** CLEAR, është më e re dhe nënkupton pranimin e ri të trashëgimisë si diçka shumë të rëndësishme për një jetë të balancuar njerëzore.

Ato duhet të jenë:

- **Bashkëpunuese** – Synimi duhet të inkurajojë sa më shumë persona që është e mundshme që të ndajnë përgjegjësinë dhe të punojnë bashkërisht në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.
- **Kufizuara** – Për të pasur objektivë të menaxhueshme, ajo duhet të jetë e kufizuar në fushëveprim.
- **Emocionale** – Të bazohen në afërsinë emocionale të personit me një komponentë të caktuar të trashëgimisë.
- **Dukshme** – Kur synimet e mëdha ndahen në detyra më të vogla, atëherë ato mund të arrihen me shpejtësi dhe lehtësi.
- **Rafinueshme** – Kjo karakteristikë i ofron planit menaxhues fleksibilitet dhe përshtatshmëri ndaj situatave të ndryshuara.

Për më tepër, objektivat (synimet) duhet të jenë:

- (1) të renditura sipas rëndësisë,
- (2) të shprehura në sasi, kudo që është e mundshme,
- (3) të përkohën me vlerat (DeS),
- (4) realiste,
- (5) të përputhshme me njëra-tjetrën, dhe
- (6) të afatizuara, kurdo që është e mundshme.



Ilustrimi 16: Synimet (objektivat) janë domosdoshmëri për një plan veprimi, ato duhet të përmbushin një seri kriteresh.

Specifike për qëllimin e PMTK dhe për tiparin/fushën/interesin, është e rëndësishme të kemi parasysh se a e arrijnë objektivat qëllimin; a janë në pajtueshmëri me zotimet; a i adresojnë kërkesat relevante të menaxhimit.


## 6.2 Aktivitetet

Është e rëndësishme që aktivitetet të strukturohen ashtu që të ndjekin analizën SWOT për çdo fushë veprimi. Aktivitetet duhet të grupohen ashtu që të korrespondojnë me çdo dhe secilin objektiv të veçantë. Ato duhet të sistematizohen në përputhje dhe sipas rëndësisë: duke filluar nga aktiviteti me prioritetin më të lartë, atë që është më urgjent!

Plani i veprimit duhet të përmbajë përkufizime të sakta të çdo aktiviteti, afatet kohore përkitazi me kohëzgjatjen dhe me fillimin, personat apo institucionet përgjegjëse, gjegjësisht në krye të aktivitetit, buxhetin e përfaqësuar, ofruesin e menduar të buxhetit në fjalë, rreziqet dhe supozimet, rezultatet e pritura, si dhe kriteret e monitorimit.

Varësisht nga konteksti, plani i veprimit mund të përmbajë informacione të tjera.

- Plani i veprimit duhet të jenë në format tabelor, i qartë dhe realist.
- Plani i veprimit duhet të bazohet në kushtin themelor referues, dhe një nga treguesit më të rëndësishëm duhet të jetë ndryshimi sasior dhe cilësor i kushtit themelor referues.
- Planet dhe skicat do të duhej përdorur për hartim të aktiviteteve ashtu që të sigurohet identifikim i qartë gjeografik për çdo veprim.
- Është e rëndësishme të sigurohet që plani i veprimit të përshtatet në përputhje me rezultatet e monitorimit.



Ilustrimi 17: Çdo veprim i renditur në plan të veprimit duhet vlerësuar karshi këtyre parametrave



## 7. Strukturat menaxhuese, monitorimi dhe kontrolli

Strukturat menaxhuese duhet përkufizuar dhe përcaktuar në përputhje me kornizën ligjore, përmbajtjen e planit të veprimit, dhe duhet bazuar në identifikimin e kapaciteteve në dispozicion – njerëzore, institucionale dhe financiare.

Strukturat menaxhuese duhet të përcaktojnë qartas lidhjet dhe marrëdhënien ndërmjet subjekteve të ndryshme të menaxhimit.


Sipas nivelit të përgjegjësisë, strukturat menaxhuese klasifikohen si:

1. drejtpërdrejt përgjegjëse për zbatim;
2. përgjegjëse për lëshimin e lejeve dhe vendimeve të tjera administrative;
3. përgjegjëse për politikat dhe vendimet politike;
4. përgjegjëse për inspektim; dhe
5. përgjegjëse për këshillim dhe konsultim.

Korniza ekzistuese institucionale përdoret për qëllim të zbatimit të planit për menaxhim të trashëgimisë kulturore. Dy pozita, gjegjësisht dy organe të reja duhen krijuar.

1. responsible on daily basis;
2. responsible periodically on the basis of request or appeal (reactive responsibility);
3. responsible periodically based on the law or regulation;
4. responsible annually based on the management plan monitoring schedule.

Struktura menaxhuese e propozuar është, si vijon:



Ilustrimi 18: Struktura menaxhuese në Kosovë (propozim)

- > Hierarkia
- - -> Bashkëpunimi joformal
- · · -> Duhet të institucionalizohet
- Vetëm në Objektet që përmbajnë Zonë të Veçantë të Mbrojtur

Korniza ekzistuese institucionale përdoret për qëllim të zbatimit të planit për menaxhim të trashëgimisë kulturore. Dy pozita, gjegjësisht dy organe të reja duhen krijuar.

E para është pozita e menaxherit të objektit, që ndahet mes menaxherit në objekt në nivel lokal dhe menaxherit të zyrës në *Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore*. Pozita e menaxherit në objekt është pozita e vetme e re që kërkon buxhet për operacione (pagë apo ndonjë lloj tjetër pagese në përputhje me ligjin) dhe mjete pune për zyre. Menaxherët e objektit janë përgjegjës për të gjitha çështjet e menaxhimit të trashëgimisë kulturore si në vijim:

- Vëzhgimi dhe analizimi në baza ditore;
- Mbikëqyrja e statusit të mbrojtur të trashëgimisë kulturore dhe vlerave të tij;
- Identifikimi, në fazë të hershme, i trendëve problematikë dhe vendimi nëse duhen sjellë në vëmendje e të tjerëve gjatë seancave për reagim të *Këshillit Menaxhues të Trashëgimisë Kulturore*;
- Veprimi si persona kontaktues për të gjitha çështjet lidhur me planin menaxhues;
- Menaxhimi i dokumenteve dhe bazës së të dhënave;
- Përgatitja dhe administrimin e tenderëve dhe të gjitha çështjeve administrative;
- Raportimi në *Këshillin Menaxhues të Trashëgimisë Kulturore* në baza vjetore;
- Raportimi në *Këshillin Menaxhues të Trashëgimisë Kulturore* në raste emergjencash apo rrethanave të veçanta të paplanifikuara;
- Prezantimi i propozimit me aktivitete të planifikuara për vitin vijues pranë *Këshillit Menaxhues të Trashëgimisë Kulturore*; dhe
- Menaxhimi i të gjitha çështjeve lidhur me zbatimin e planit të veprimit.

Menaxherët në objekt dhe në zyre rajonale i bashkërendojnë aktivitetet në baza ditore.

Krijimi i dytë i ri, gjegjësisht organi i dytë i ri që duhet krijuar është *Këshilli Menaxhues i Trashëgimisë Kulturore* (KMTK). KMTK është organ i themeluar për monitorimin e planit menaxhues dhe përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha subjekteve menaxhuese të përfshira drejtpërsëdrejti.



Anëtarët e përhershëm të KMTK janë:

- *Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Departamenti për Trashëgimi Kulturor;*
- *Instituti Arkeologjik i Kosovës;*
- *Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor;*
- *Komuna: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm;*
- Dhe anëtarët e tjerë të përkohshëm: anëtarët e përkohshëm të Këshillit mund të jenë përfaqësuesit e cilësdo palë të interesit, institucioni apo organi, varësisht nga tema e takimeve apo kërkesa për përshtatjen e planit ndaj rrethanave të mundshme.

*Këshilli Menaxhues i Trashëgimisë Kulturore* takohet rregullisht në baza vjetore, dhe nëse kjo kërkohet, me qëllim reagimi.

Përgjegjësitë e KMTK-së janë:

- Monitorimi i arritjes së objektivave në PMTK në baza vjetore;
- Shqyrtimi i performancës dhe efikasitetit të strukturave menaxhuese;
- Monitorimi reagues në bazë të kërkesave apo emergjencave të paplanifikuara;
- Miratimi dhe shpërndarja e raporteve vjetore tek të gjitha palët kryesore të interesit;
- Marrja e vendime për dërgimin e kërkesave tek organet e tjera – politik-bërësit, donatorët, palët e interesit, etj., duke përfshirë aktivitetet për ngritje të fondeve;
- Shqyrtimi dhe miratimi në baza vjetore i listës së aktiviteteve me prioritet;
- Miratimi i planit vjetor afat-shkurtër të aktiviteteve bazuar në planin menaxhues (që i përshtatet kontekstit, vetëm nëse arsyetohet nevoja për një gjë të tillë)
- Informimi i publikut (përmes kumtesave për shtyp, konferencave, etj.) për konkluzionet dhe gjendjen e konservimit të një objekti të trashëgimisë kulturore.

Për shkak se rrethanat ndryshojnë, strategjia menaxhuese duhet t'i përshtatet ndryshimeve duke i qëndruar besnik drejtimit të duhur sa i përket parimeve bazike të qëllimit dhe objektivave.

## 8. Përfundime

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore, bartja e saj tek gjeneratat e reja, si dhe përhapja e dijes janë detyra sfiduese. Për t'i kryer këto detyra në mënyrë gjithëpërfshirëse, nevojitet stil i veçantë menaxhimi. Plani menaxhues i trashëgimisë kulturore përbën në thelb koncept të integruar të planifikimit dhe veprimit që përcakton synime dhe masa për mbrojtjen, konservimin, përdorimin dhe zhvillimin e objekteve të trashëgimisë kulturore (ose natyrore). Plani koherent ofron vizion, qëllime dhe veprime të caktuara të dizajnuara për t'i adresuar nevojat e banorëve (si dhe të palëve tjera të interesit) për objektin e trashëgimisë kulturore dhe/ose natyrore.

Struktura e planit menaxhues ndjek modelet e mirëpërcaktuara dhe të provuara paraprakisht, siç janë: përshkrimi i objektit dhe rëndësia e tij; themelimi i kornizës legjislative, administrative dhe procedurale, organizimi i infrastrukturës menaxhuese, formulimi i vizioneve dhe qëllimeve, si dhe hartimi i planit të veprimit. Megjithatë, hartimi i planit nuk duhet që thjeshtë ta demonstroj dëshirën për ta përcjellë trendin aktual dhe të përhapur për krijimin e një sistemi të menaxhimit. Plani i tillë duhet të rrënjohet në "mjedisin" lokal duke e marrë parasysh karakterin shumë individual të çdo objekti të trashëgimisë

dhe nevojën për të përshtatur menaxhimin, mbrojtjen, shpërndarjen dhe bartjen në situata, kërkesa dhe nevoja specifike. Çdo procedurë planifikimi dhe përfundimisht rezultati i çdo pune hartuese është i ndryshëm. Prandaj, është me rëndësi kritike që planifikimi të zhvillohet me ndërveprim të ngushtë të palëve të interesit, me qëllim të arritjes së shkallës së lartë të "pronësisë lokale", jo vetëm sa i përket planit por edhe karshi trashëgimisë.

**Duke i vendosur njerëzit, veçanërisht komunitetin që jeton në zonat e trashëgimisë kulturore, në qendër të menaxhimit të trashëgimisë. Trashëgimia kulturore dhe natyrore mund të luajnë rol qenësor në zhvillimin e shoqërisë në baza të qëndrueshme.**



Ky Udhëzues shpjegon kushtet, hapat si dhe qasjet e mundshme në krijimin e një sistemi menaxhimi për objektet e trashëgimisë kulturore. Sidoqoftë, hartimi i planit të menaxhimi mbetet procedurë e kushtueshme dhe e gjatë, veçanërisht kur pikëpamjet dhe pritjet e komuniteteve lokale, duhet të merren në konsideratë në mënyrë të duhur në plan. Mirëpo, nuk është vetëm perspektiva lokale ajo që është me rëndësi (megjithëse kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në "pronësinë lokale" të planit), por duhet të arrihet edhe një qëllim më i gjerë. "Strategjia Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore 2017 – 2027" (Strategjia), në mënyrë të veçantë masa 2.1.3 "hartimi i planeve të menaxhimit dhe caktimi i njësive menaxhuese për objektet kryesore të trashëgimisë kulturore" thekson rëndësinë e përpilimit të planeve të tilla dhe e lidh atë ngushtë me zhvillim të qëndrueshëm. Kjo masë nënvizon një funksion tjetër të rëndësishëm të planit të menaxhimit për pasurinë kulturore, përkatësisht nevojën për bashkëpunim ndër-institucional dhe ndër-sektorial për të arritur jo vetëm mbrojtje, por edhe zhvillim në një mënyrë të qëndrueshme duke respektuar plotësisht të drejtat e pronarëve dhe zotëruesve të trashëgimisë.

**Rrjedhimisht, plani i menaxhimit duhet të shërbejë si instrument për ndërtimin e besimit mes komuniteteve në Kosovë: komunitetet jo-shumicë ushtrojnë diskrecionin e plotë në administrimin e trashëgimisë së tyre dhe përfitojnë nga qasja në pasuritë e tyre kulturore.**


Kjo kërkesë përfshin edhe restaurimin dhe ruajtjen e monumenteve të tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare duke zbatuar plotësisht kornizën ligjore përkatëse në Kosovë.



## Bibliografia

- Beverland, M., *Brand Management: Co-creating Meaningful Brands. 1st edition* (Newbury Park: Sage 2018).
- English Heritage, *Building Environment (Practical Building Conservation)* (Farnham: Ashgate Publishing, 2014).
- Feilden, B. M., Jokilehto, J., *Management Guidelines for World Cultural Heritage Sites. Second Edition ed.* (Rome: ICCROM 1998).
- Historic England, *Heritage Counts 2014: 1 The Value and Impact of Heritage*, (London: Historic England, 2014), <https://historicengland.org.uk/content/heritage-counts/pub/2014/value-impact-chapter-pdf/> [vizituar më 16 nëntor 2018].
- Historic England, *Heritage Counts 2017: Heritage and the Economy* (London: Historic England, 2017), <https://content.historicengland.org.uk/content/heritage-counts/pub/2017/heritage-and-the-economy-2017.pdf> [vizituar më 20 nëntor 2019].
- Howard, P., *Heritage: Management, Interpretation, Identity* (Leicester: University Press 2003).
- Jokilehto, J., "Considerations on authenticity and integrity in world heritage context", *City & Time*, Issue 2 (1):1 (2006), pp. 1-16, [URL:http://www.ct.ceci-br.org](http://www.ct.ceci-br.org) [vizituar më 14 nëntor 2019].
- Kirshenblatt-Gimblett, B.: "Theorizing Heritage", *Ethnomusicology* 39 (Champaign / Illinois: University of Illinois Press, 1995), pp. 367-380.
- Landorf, C., "A Framework for Sustainable Heritage Management: A Study of UK Industrial Heritage Sites", *International Journal of Heritage Studies*, Issue 15:6 (2009), pp. 494-510.
- Lowenthal, D., *The Past is a Foreign Country* (Cambridge: Cambridge University Press, 1985).
- Mason, R., "Assessing Values in Conservation Planning: Methodological Issues and Choices", in: M. d. I. Torre (ed.), *Assessing the Values of Cultural Heritage (Research Report)*, (Los Angeles: The Getty Conservation Institute, 2002), pp. 5-31, [https://www.getty.edu/conservation/publications\\_resources/pdf\\_publications/pdf/assessing.pdf](https://www.getty.edu/conservation/publications_resources/pdf_publications/pdf/assessing.pdf) [vizituar më 20 shkurt 2020].
- Nared, J., Razpotnik-Visković, N. (eds.), *Managing Cultural Heritage Sites in Southeastern Europe* (Ljubljana: Založba ZRC, 2014).
- Pedersoli, J. L. J., Antomarchi, C., Michalski, S., *A Guide to Risk Management of Cultural Heritage. 1st edition ed.* (Rome: ICCROM; Government of Canada, Canadian Conservation Institute 2016), [https://www.iccrom.org/wp-content/uploads/Guide-to-Risk-Management\\_English.pdf](https://www.iccrom.org/wp-content/uploads/Guide-to-Risk-Management_English.pdf) [vizituar më 12 nëntor 2019].
- Riegl, A., "The Modern Cult of Monuments: Its Character and Its Origin (Moderner Denkmalkultur: sein Wesen und seine Entstehung)", *Oppositions*, Fall 1982, Issue 25, pp. 21-51.
- Ringbeck, B., *Management Plans for World Heritage Sites. A practical guide* (Bonn: German Commission for UNESCO, 2008), [https://www.unesco.de/sites/default/files/2018-05/Management\\_Plan\\_for\\_World\\_Heritage\\_Sites.pdf](https://www.unesco.de/sites/default/files/2018-05/Management_Plan_for_World_Heritage_Sites.pdf) [vizituar më 2 nëntor 2019].

- Scientific Research Center of the Slovenian Academy of Science and Arts (Slovenia), *Cultural Heritage Environmental Planning Model for SEE D6.2: Environmental Planning Model for Cultural Heritage Sites in Southeastern Europe* (2014), [http://www.Environmental+planning+model+for+cultural+heritage+sites+in+Southeast+Europe%20\(1\).pdf](http://www.Environmental+planning+model+for+cultural+heritage+sites+in+Southeast+Europe%20(1).pdf) [accessed 20 November 2018].
- UNESCO, *Managing Cultural World Heritage* (Paris: UNESCO World Heritage Centre, 2013), <https://whc.unesco.org/document/125839> [vizituar më 2 nëntor 2019].
- UNESCO, *Culture: urban future; global report on culture for sustainable urban development* (Paris: UNESCO, 2016), <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000245999> [vizituar më 14 nëntor 2019].



# Instrumentet ligjore dhe normat e padetyrueshme


(në renditje kronologjike)

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, (Paris: UN-GA, Res. 217A, 10 dhjetor 1948), [https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/eng.pdf](https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf) [vizituar së fundi më 4 mars 2020].
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomika, Sociale dhe Kulturore, (New York: UN-GA, 16 dhjetor 1966, GA Res 2200A [XXI]), <https://www.un.org/ruleoflaw/blog/document/international-covenant-on-economic-social-and-cultural-rights/> [vizituar më 4 mars 2020].
- Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore të Botës (Konventa e Trashëgimisë Botërore 1972), (Paris: UNESCO, 16 nëntor 1972), <https://whc.unesco.org/en/conventiontext/> [vizituar së fundi më 4 mars 2019].
- Deklarata e Amsterdimit (Amsterdam Declaration 1975), (Amsterdam: Kongresi i Trashëgimisë Arkitekturale Evropiane / Këshilli i Evropës, 21-25 tetor 1975), <https://rm.coe.int/090000168092ae41> [vizituar më 4 nëntor 2019].
- Karta Evropiane e Trashëgimisë Arkitekturale (Strasbourg: Këshilli i Evropës, 1975), [https://search.coe.int/cm/pages/result\\_details.aspx?objectid=09000016804a8a7c](https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectid=09000016804a8a7c) [vizituar më 4 nëntor 2019].
- Dokumenti i Nara-s mbi Autenticitetin (Paris: ICOMOS, 1994), <https://www.icomos.org/charters/nara-e.pdf> [vizituar më 4 nëntor 2019].
- Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Vlerat e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë (Konventa Faro 2005), (Faro: Këshilli i Evropës, 27 tetor 2005), <https://www.coe.int/en/web/culture-and-heritage/faro-convention> [vizituar më 4 nëntor 2019].
- Udhëzuesit Operacionalë për Zbatimin e Konventës për Trashëgiminë Botërore, (Udhëzimet Operacionale 2005), (Paris: UNESCO World Heritage Centre and World Heritage Committee 2005), <https://whc.unesco.org/archive/opguide05-en.pdf> [vizituar më 24 tetor 2019].
- Ligji Nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore, 1 korrik 2008.
- Ligji Nr. 03/L-039 për zonat e veçanta të mbrojtura, 4 qershor 2008.
- *Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027*, 30 dhjetor 2016, [https://mkrs-ks.org/repository/docs/eng\\_strategy\\_for\\_heritage.pdf](https://mkrs-ks.org/repository/docs/eng_strategy_for_heritage.pdf) [vizituar më 24 maj 2020]
- Objektivat për Zhvillim të Qendrueshëm të OKB (SDG 2030), (2015), <https://sustainabledevelopment.un.org/> [vizituar më 14 nëntor 2019].
- Udhëzuesit Operacionalë për Zbatimin e Konventës për Trashëgiminë Botërore, (Udhëzimet Operacionale 2019), (Paris: UNESCO Qendra e Trashëgimisë Botërore edhe Këshilli i Trashëgimi Botërore 2019), <https://whc.unesco.org/document/178168> [vizituar më 12 shkurt 2020].

# Lista e ilustrimeve

Ilustrimi 1: "Rrota që sillet" e menaxhimit të trashëgimisë kulturore (dizajni nga: A. Haxhimuhamedoviq)	17
Ilustrimi 2: Përkufizimi i "vlerës së jashtëzakonshme universale" të trashëgimisë botërore (modeli: Misioni i OSBE-së në Kosovë)	19
Ilustrimi 3: Kushtet për një plan për menaxhimin e trashëgimisë kulturore (dizajni: A. Hadžimuhamedović)	20
Ilustrimi 4: Fazat e procesit të planifikimit të menaxhimit (dizajni: A. Hadžimuhamedović)	25
Ilustrimi 5: Ndërvarësia e segmenteve të ndryshme të procesit për planifikimin e menaxhimit (dizajni: A. Hadžimuhamedović)	26
Ilustrim 6: Palët e interesit si pjesë e menaxhimit të trashëgimisë kulturore (Dizajni: A. Hadžimuhamedović)	36
Ilustrimi 7: Pajtimi i nevojave të ndryshme dhe shpesh kundërshtuese të palëve të interesit gjatë procedurës së hartimit të planit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. (Dizajni: A. Hadžimuhamedović)	37
Ilustrimi 8: Shembull i një harte të rruges për të identifikuar dhe vlerësuar palët e interesit (dizajni: A. Hadžimuhamedović)	38
Ilustrimi 9: Shembull i një plani të rrënojave të një kështjelle me referenca kronologjike të fazave të ndërtimit, duke filluar nga mesi i shekullit 11 (e verdhë) deri në shekullin 20 (e gjelbër) (në: <a href="https://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/7/76/Burg_Raabs_neu.jpg">https://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/7/76/Burg_Raabs_neu.jpg</a> )	48
Ilustrimi 10: Gjatë fazës së vlerësimit të hartimit të një plani të menaxhimit, duhet të merren parasysh shumë aspekte - shpeshherë divergjente . (dizajni: A. Hadžimuhamedović).	52
Ilustrimi 11: Tabela e vlerave të trashëgimisë në kornizën e qasjes së bazuar në vlera, sipas Randal Mason. (dizajni: A. Hadžimuhamedović)	53
Ilustrimi 12: Skema e vlerësimit të vlerës së trashëgimisë kulturore në Mbretërinë e Bashkuar (në: Anglinë Historike 2014)	54
Ilustrimi 13: metoda SWOT mbulon faktorët e brendshëm (të cilët shkaktojnë përparësi ose dobësi) dhe aspektet e jashtme (si mundësitë dhe rreziqet. (dizajni: A. Hadžimuhamedović)	59
Ilustrimi 14: Menaxhimi i rrezikut përfshin të tre fazat: para-, gjatë - dhe pas ndodhjes së fatkeqësive. Ky qark: parandalimi - zbutja - rimëkëmbja tregon detyrën e përhershme të menaxhimit të rrezikut meqë "pas-fatkeqësia është para fatkeqësisë". (dizajni: Misioni i OSBE-së në Kosovë).	60
Ilustrimi 15: Menaxhimi i rrezikut kërkon qasje gjithëpërfshirëse duke marrë parasysh shumë aspekte që mund të shkaktojnë fatkeqësi ose që do të jenë pasojë e shfaqjes së tyre. (dizajni: A. Hadžimuhamedović).	62
Ilustrimi 16: Synimet (objektivat) janë domosdoshmëri për një plan veprimi, ato duhet të përmbushin një seri kriteresh. (dizajni: A. Haxhimuhamedoviq)	65
Ilustrimi 17: Çdo veprim i renditur në plan të veprimit duhet vlerësuar karshi këtyre parametrave (dizajni: A. Haxhimuhamedoviq)	66
Ilustrimi 18: Struktura menaxhuese në Kosovë (propozim) (dizajni: A. Hadžimuhamedović) .	68





# ■ Udhëzues për standardet e hartimit të planeve menaxhuese të trashëgimisë kulturore

